



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2019, ora 11:00

Drejtojnë mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi nën për nen i projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Kostaq Papa, Selami Jenishehri dhe Klajdi Qama.

Mungojnë:

Enada Kapllani dhe Mirela Kumbaro.

Deputetë të grupit propozues:

Eglantina Gjermeni.

Të ftuar:

Shaban Sinani – akademik, anëtar i grupit të punës për hartimin e projektligjit,

Vasil Tole – sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave,

Erzen Tola – drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MASR.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Sot në rendin e ditës do të kemi diskutimin nën për nën dhe në tërësi të projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh.

Të pranishëm në këtë mbledhje nga të ftuarit janë: zoti Shaban Sinani, anëtar i grupit të punës për hartimin e projektligjit, zoti Kosta Barjaba, anëtar i grupit të punës për hartimin e projektligjit, dhe zoti Erzen Tola, drejtor i Përgjithshëm i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit.

Përpara se të vijojmë me diskutimin dhe shqyrtimin nën për nën të projektligjit, nga të ftuarit mendojmë se duhej të ishin të pranishëm edhe grupi i deputetëve nismëtarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendoni se është i mjaftueshëm komisioni për të dhënë ekspertizën gjatë shqyrtimit nën për nën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I ka të shkruara materialet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Shaban Sinani, anëtar i grupit të punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Mund ta marr fjalën për procedurë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni, zonja Ekonomi!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja kryetare!

Për procedurë, unë mendoj që të kishim prezent në mbledhjen e sotme edhe një përfaqësues nga Akademia e Shkencave, jo nga grupi i punës, sekretarin e Akademisë, zotin Vasil Tole, i cili e ka ndjekur këtë proces nga fillimi e deri tani, sikurse e ka ndjekur edhe Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.

Nuk e di nëse kolegët e komisionit bien dakord me këtë propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Personalisht mendoj se zoti Tole nuk është pjesë e grupit të punës.

Milva Ekonomi – Jo, unë mendoj...

Fatjona Dhimitri – Akademia ka edhe përfaqësues të tjerë, përveç zotit Tole, për t'u paraqitur këtu dhe për të dhënë ekspertizën e tyre.

Milva Ekonomi – Mendimi juaj është shumë i vyer, shumë i vlefshëm, por unë mendoj që propozimi të hidhet në votë. Ju keni të drejtë të keni mendimin tuaj, por unë mendoj se propozimi im duhet të votohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Ju mund të keni forcën e votës, sepse, normalisht, pjesa e maxhorancës dominon në këtë komision, por mendoj se zoti Tole është thirrur mjaftueshëm, e ka dhënë mendimin e tij 100% pro këtij projektligji dhe nuk besoj se mendimi i tij është ndonjë risi për këtë komision.

Gjithsesi, e hedhim në votë nëse duhet të jetë ose jo i pranishëm në komision zoti Tole. Kush është pro? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Tole mund të thirret në komision.

Milva Ekonomi – Edhe diçka tjetër për procedurë.

Unë nuk e di se çfarë mund të shtojë tani zoti Sinani ose zoti Tola në diskutimin që do të bëjmë sot. Mendoj se fjala i duhet dhënë relatorit, sepse i kemi lënë një detyrë nga mbledhja e kaluar që të merrte në konsideratë të gjitha çështjet që kishin ardhur në komision për këtë gjë dhe së bashku me një grup pune, që përbëhej nga këshilltari juridik i komisionit dhe nga dy këshilltarët, që vinin nga grupi i punës dhe nga ministria, të na jepnin një version integral.

Kështu, ndoshta do të ishte e udhës të dëgjonim relatorin, përpara se t'ua jepnim fjalën anëtarëve të Akademisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe këtë e kisha për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Përpara se t'ia jap fjalën relatorit, lidhur me pjesën e të ftuarve, ishte parashikuar në listën e të ftuarve zoti Kosta Barjaba, shefi i kabinetit të Kryetarit të Kuvendit. Zoti Barjaba është larguar për momentin. Mund të jetë pjesë e grupit të punës, por normalisht është në konflikt interesi lidhur me detyrën e tij për të qenë i pranishëm sot këtu.

Zoti relator, mund ta merrni fjalën.

Milva Ekonomi – Dua të bëj një sqarim, për procedurë, zoti Barjaba është akademik, pra është anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave, përpara se të bëjë detyrën e këshilltarit.

Fatjona Dhimitri – Fatkeqësisht, u këmbuem rrugës këtu, ndoshta këmbehet me zotin Tole.

Urdhëroni, zoti Ismet, fjala është për ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, se ia kam dhënë fjalën zotit Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje të gjithëve!

Projektligji që kemi për diskutim sot nen për nen, ka kaluar të gjitha stadet, që nga ngjizja dhe ngritja e grupit të punës deri te marrja e mendimeve të botës akademike, të institucioneve të kërkimit shkencor, të institucioneve të arsimit të lartë, të deputetëve. Ndaj, gjithkush që ka dhënë mendim të vyer deri tani, është i vlerësuar dhe i respektuar, sikurse janë ata që e kanë ndihmuar këtë çështje, duke bërë vlerësime në aspektin kritik për këtë projektligj.

Ne kemi kaluar një sërë dëgjësash dhe unë, si relator i këtij komisioni të nderuar, që m'u dha si detyrë, kam pasur objektiv të sjell sot në diskutimin nen për nen projektin integral, i cili ka për bazë projektligjin e paraqitur si nismë e një grupi deputetësh, që vijnë nga bota akademike dhe ku kolona kryesore janë mendimet dhe propozimet e të gjithë këtyre faktorëve që përmenda më lart, nga bota akademike, institucionet, akademikët dhe nga njerëz të shkencës e kulturës në vendin tonë.

Pa dashur të zgjatem më tej, po filloj nga prezantimi i projektligjit nen për nen para këtij komisioni të nderuar. Ndryshimet përkatëse janë reflektuar dhe do të them konkretisht se çfarë. Është e drejta e komisionit pastaj t'i diskutojë dhe t'i miratojë.

Fillojmë me nenin 1. Qëllimi i këtij projektligji mbetet ashtu siç është propozuar nga grupi nismëtar, pra nuk ka ndryshime për këtë nen. A është e nevojshme ta lexoj?

Fatjona Dhimitri – Zoti Beqiraj, ndjesë që ju ndërpres!

Mua më ka rënë në dorë relacioni juaj, ku janë parashikuar propozimet dhe mendimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Në relacion janë parashikuar propozimet dhe mendimet e Këshillit të Ministrave, të disa deputetëve të maxhorancës, anëtarë të këtij komisioni, si dhe janë reflektuar mendimet e rektorit të Universitetit të Sporteve. Por të mos harrojmë që në dëgjësat tona kemi pasur edhe grupe të tjera interesi, si: Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Durrësit...

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

Fatjona Dhimitri – Pra, po flas mendimet konkrete të Universitetit të Durrësit dhe jo mendimet personale të zotit Lekë Sokoli, si zëvendësrektor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

Fatjona Dhimitri – Ismet, të lutem! Kemi pasur të pranishëm zotin Fuga këtu, por asnjë vërejtje dhe reflektim i tij nuk është paraqitur në relacionin tuaj!

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

Fatjona Dhimitri – Në relacionin që unë disponoj... Në qoftë se ne nuk do t'i marrim parasysh të gjitha këto lloj vërejtjesh në këtë lloj relacioni, por do të vijojmë “Hajde, se projektligji është vullnet i njëres palë politike dhe duhet ta kalojmë me patjetër të enjten në Kuvend”, atëherë të vazhdojmë kështu me këtë lloj ritmi!

Në qoftë se të gjitha vërejtjet e ministrisë...

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare, ju lutem, mos më ndërprisni, sepse kam marrë fjalën tani!

Fatjona Dhimitri – Do t'jua jap unë fjalën, patjetër që po!

Ismet Beqiraj – Jo, jo, ju lutem!

Fatjona Dhimitri – Në qoftë se të gjitha propozimet e dëgjesave këtu, e anëtarëve...

Ismet Beqiraj – Sipas Rregullores, mos më ndërprisni fjalën!

Fatjona Dhimitri – Ismet, në qoftë se të gjitha propozimet e universiteteve, të rektorëve që kanë qenë të pranishëm këtu, edhe ato të zotit Fuga apo edhe të ndonjë tjetri, që kanë pasur një mendim alternativ lidhur me projektligjin, nuk reflektohen, atëherë unë refuzoj të bëhem pjesë e kësaj farse në këtë komision dhe vazhdojeni e shqyrtojeni ju projektligjin deri në fund!

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

Milva Ekonomi – Për procedurë.

Zonja kryetare, ku e dini ju që kjo është fares, kur ju nuk e keni parë ende variantin integral?! Si mund ta paragjykoni ju një punë të bërë nga anëtarët e komisionit?!

Fatjona Dhimitri – Si mund të arrijmë ne të trupëzojmë dhe të arrijmë në një projektligj integral, kur në relacion nuk i kemi marrë parasysh ato lloj mendimesh dhe propozimesh?!

Milva Ekonomi – Merreni projektligjin e integruar, që ua lamë detyrë grupit të punës dhe këshilltarëve të komisionit ta përgatisin...

Fatjona Dhimitri – Mbi të gjitha, a ka ky komision anëtarë...

Milva Ekonomi – Më lini ta mbaroj fjalën!

Fatjona Dhimitri – A ka anëtarë akademikë ky komision për ta relatuar deri në fund projektligjin?

Milva Ekonomi – Më lini një herë ta mbaroj idenë!

Tani, ne u thamë njerëzve të ngarkuar me këtë punë: merrni të gjitha vërejtjet që kanë ardhur, shikojini dhe kuptojini a kanë kuptim për t'u përfshirë apo jo. Natyrisht, jo të gjitha vërejtjet do të jenë pjesë e këtij projektligji të ri, që po të vjen në dorë!

Kur ta lexosh nenin, atëherë mund të thuash nëse është ose jo farsë! Si e paragjykoni pa e parë një herë?! Ju nuk e dini se sa shumë gjëra janë përfshirë, siç nuk e di as unë. Prandaj, hajdeni ta marrim punën në dorë dhe pastaj ta gjykojmë.

Fatjona Dhimitri – Me sa shoh, në atë relacion janë mendimet e zonjës Aurela Anastasi, një profesoreshë shumë e nderuar; të rektorit të Universitetit të Sporteve; të Këshillit të Ministrave, si dhe propozimet e zonjës Eglantina Gjermani, zoti Ismet, vetëm kaq. Nuk po shoh aty as mendimin konkret të Universitetit të Durrësit, që mund të jetë mendim alternativ dhe asgjë tjetër!

Milva Ekonomi – A e lexuat mendimin konkret të Universitetit të Durrësit? Ishte thjesht një mendim në parim dhe kishte vetëm një rregullim në një nen të caktuar. A i patë ato gjëra? A i shikoni të dhëna të varianti i ri? Në fund të fundit, çfarë mendimi kishte Universiteti i Durrësit?! Një gjë, kështu flu, dhe vetëm një rregullim neni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur ta shqyrtojmë nen për nen, mund ta shikosh nëse është apo nuk është përfshirë. Çfarë janë këto diskutime koti që bëhen tani?!

Kostaq Papa – A mund ta marr fjalën?

Fatjona Dhimitri – Po, mundeni.

Ismet Beqiraj – Jo, të lutem, fjala m'u dha mua.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, të lutem.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, për procedurë dhe unë e ndërpres, por nuk më duket korrekte.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Zoti Kosta, lëreni të vazhdojë!

Ismet Beqiraj – Të lutem, jo vetëm kaq, por edhe unë e përgënjeshtroj atë që sapo propozoi kryetarja. Sa për dijeni, ne i kemi marrë të gjitha propozimet dhe mendimet që ka

dhënë akademiku Fuga një për një, dhe relatori i këtij komisioni i ka nënvizuar, konspektuar dhe i ka marrë të gjitha një e nga një.

Fatjona Dhimitri – Ku janë të parashtruara, Ismet?

Ismet Beqiraj – Të lutem, mos debato!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Gjeji ku janë parashtruar.

Ismet Beqiraj – Në nenin 1, që bën vërejtje dhe propozon zoti Fuga, ku thuhet: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktim i bazave juridike”, pra është një gjuhë e vjetër dhe e sforcuar përdorimi “baza juridike”. Çfarë do të përfaqësojë? Pra, i ka marrë një për një. A doni të vazhdoni me “xhevahire” të tjera?

Zonja kryetare, edhe ju i keni lexuar, prandaj mos e kini merak se i kam marrë një për një, sepse më shumë se të gjithë e kam pasur merak unë. Profesorin e kam pritur që ta ndihmoj dhe kam kërkuar që ai të japë realisht mendime racionale, prandaj i ndërhyra atë ditë, sepse më intereson të marr pjesën më racionale të propozimeve konkrete.

Fatjona Dhimitri – Aty nuk është e parashikuar ekspertiza e të huajve. Në komision nuk janë të pranishëm akademikë, të cilët mund të të japin ty një mendim konkret për relatin deri në fund të projektligjit.

Ismet Beqiraj – Të lutem, nuk mundem t’u përgjigjem pyetjeve tuaja; ne jemi të barabartë në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë jam relator dhe po të prezantoj atë material me ato mendime. Këtu janë të gjitha mendimet dhe propozimet e atyre që kanë bërë amendime direkte, si: Këshilli i Ministrave, deputetët: Eglantina Gjermeni, Ismet Beqiraj, Aurela Anastasi, Agron Cuka dhe Mirela Kumbaro, si dhe rektori i Universitetit të Sporteve, i cili ka bërë direkt amendime, ndërsa të tjerët vetëm kanë diskutuar në parim. Ne i kemi pasqyruar të gjitha ndryshimet. Këtu kemi një listë të gjatë, ku kemi përfshirë edhe profesor Fugën, prandaj mos e keni merak.

Fatjona Dhimitri – Ismet nuk e kam merak, sepse nuk po mbroj asnjë palë.

Ismet Beqiraj – Në nenin 1 është “Qëllimi” dhe mbetet ashtu siç është propozuar nga grupi nismëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka pasur propozime të tjera, pra nuk ka pasur amendamente dhe as mendime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë kështu e di, kur diskutohet nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ismet, kam një propozim: a mund ta ndalësh pak diskutimin, sa të bëhen fotokopjet e projektligjit, në mënyrë që ta kemi të gjithë përpara?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Për mendimin tim, nuk duhet vazhduar. Ju e keni votën dhe ju vendosni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ju keni thirrur mbledhjen dhe keni firmosur sot, prandaj do të rrini dhe t’i dëgjoni patjetër këto nene. Pastaj, kur të hidhen në vote, mund të thoni “po” ose “jo”, ashtu siç kemi punuar gjithmonë.

Fatjona Dhimitri – Mua nuk më detyron askush që të jem e pranishme në një mbledhje, ku janë marrë parasysh vetëm disa mendime dhe janë lënë mendimet e tjera. Edhe nëse do t’i diskutojmë, ne do të diskutojmë ato mendime që janë pjesë e një vullneti politik.

Ju mund të vazhdoni ta zhvillon mbledhjen vetëm me njërën palë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Kryetarja e Komisionit, Fatjona Dhimitri, largohet nga mbledhja.)

Milva Ekonomi – Këto ngjarje përsëriten herë pas here nga kryetarja e re, e cila, me sa kuptoj, nuk e di Rregulloren e Kuvendit dhe nuk e di se si veprohet në raste të tilla, kur ka një projektligj për t’u diskutuar, sepse kam përshtypjen se nuk e ka kaluar asnjëherë me vëmendje se çfarë pune kërkon një projektligj.

Këtë projektligj ne e kemi votuar në parim; kemi bërë dëgjesa; kemi pritur mendimin e Këshillit të Ministrave dhe tani do të diskutojmë nen për nen, në bazë të komenteve që kanë dhënë grupet e interesit. Ne duhet të hedhim në votë çdo nen, i cili pasqyron ndryshimet sipas propozimeve të bëra nga ata që kanë qenë në dëgjese.

Meqenëse kryetarja e la mbledhjen e komisionit, sipas Rregullores, unë duhet ta vazhdoj mbledhjen.

Ju lutem, mbledhjen do ta ndërpresim për një minutë sa të gjejmë nenin e Rregullores.

(Drejtimin e komisionit e merr nënkryetarja, Milva Ekonomi)

Mirëdita edhe një herë!

Jemi në një situatë të pazakontë, ku mbledhja ka filluar e thirrur nga kryetarja e komisionit, me një agjendë të përcaktuar, për të diskutuar nen për nen projektligjin “Për Akademinë e Shkencave” dhe kryetarja e komisionit ka lënë mbledhjen.

Të pranishëm janë anëtarët e komisionit, pjesë të opozitës dhe të pozitës. Në bazë të nenit 23 të Rregullores së Kuvendit, ku shpjegohen detyrat e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të komisionit, thuhet: “Zëvendëskryetari zëvendëson kryetarin në rastin e mungesës së tij ose kur ai nuk ka mundësi ta kryejë detyrën”. Kjo është pika 2 e nenit 23.

Përpara se të vazhdojmë mbledhjen, do t’ia jap fjalën sekretarit për të na thënë nëse e kemi kuorumin e nevojshëm për të vazhduar mbledhjen.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë dhe mund të vazhdojmë mbledhjen normalisht.

Më vjen keq për kryetaren, sepse menduam se na iku një kryetare që ishte shumë agresive dhe na erdhi një tjetër, e cila do ta fuste komisionin në rrugën e normalitetit dhe të zbatimit të Rregullores, por posti i kryetarëve të opozitës është shumë i vështirë për t’u menaxhuar. Megjithatë, ne do të vazhdojmë punën tonë, sepse kuorumi është i plotë dhe ne mund të vazhdojmë punën normalisht.

Milva Ekonomi – Edhe një herë, për të marrë pjesë në punën e komisionit, kemi ftuar anëtarët nismëtarë të këtij projektligji, të cilët janë deputetë. Kemi të ftuar anëtarët e grupit të punës nga Akademia e Shkencave, si: zotin Shaban Sinani dhe zotin Vasil Tole, për të cilët morëm një vendim të gjithë bashkë që t’i thërrasim. Gjithashtu, kemi të ftuar edhe përfaqësuesin ligjor të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.

Fjalën e ka zoti Papa.

Kostaq Papa – Përshëndetje!

Së pari, me përgjegjësinë e duhur ju kërkoj që t’i përkushtohemi ligjit për Akademinë.

Së dyti, nëse duam një ligj të mirë që t’i rezistojë kohës gjatë, por edhe t’i shërbejë Akademisë për të prodhuar sa më shumë vlera, gjatë kalimit të ligjit ne duhet të zhvishemi nga ngjyrimi partiak, nga interesa të vogla dhe mesquine. Ju votat i kenë, por ne duam një ligj të pranueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Së treti, unë jam një mbrojtës i mirë i ministres së Arsimit, por dëgjesa me ministren ishte fiasko e vërtetë, sepse ajo foli vetëm pak minuta përmbledhëse dhe vetëm për pjesën e parë, pastaj tha: “Ia kaloj fjalën specialistit, nëse keni ndonjë pyetje”. Shikoni materialin e transkriptuar për këtë dëgjese. Dua të them që iu përgjigj disa pyetjeve, por pyetjet janë aspekt tjetër, kurse komenti i saj ishte i cekët dhe i pjesshëm; as specialistët, për të cilët ajo ndërpreu fjalën, nuk folën. E vetmja gjë e mirë në fjalën e saj ishte shprehja: “...për një lidhje të Akademisë me akademitë e tjera shqiptare”, pavarësisht cektësisë së shprehjes së saj. Këtë e ka shprehur edhe profesor Lekë Sokoli, edhe të tjerë, ndoshta në mënyrë të cekët.

Së katërti, jam për një projektligj, ku të jetë i shtrirë në tërësinë e tij nervi kombëtar dhe të jetë i shprehur mirë bashkëpunimi, bashkëveprimi, sinergjia, lidhja e, pse jo, përpjekja për bashkimin e akademive shqiptare kudo në perspektivën e rrethanave historike.

Së pesti, jo vetëm për një ligj të mirë e të paanshëm, por edhe për të zvogëluar kontestimin e tij nga palët apo grupet e interesit, ndoshta do të ishte e udhës, për sa e lejon procedura në komision, që akademiku Vaso Tole, si përfaqësues i draftit, akademiku Fuga, si përfaqësues i platformës së tij, ndonjë profesor universiteti apo edhe zoti Shtino, si përfaqësues i ministrisë, të ndjekin formulimin përfundimtar të ligjit dhe aspektet universitare të këtij ligji, me qëllimin për të zvogëluar kontestimin dhe për të çuar ligjin për Akademinë në nivelin më të mirë të mundshëm, sepse me këshillim dhe bashkëpunim mund të bëhen rregullime në kohë dhe nuk do të duhet kohë tjetër.

Së gjashti, është konstatuar një shkelje që më detyron t'u them përfaqësuesve të djathtë të konsultohen pas këtij momenti, sepse është konstatuar dhe paralajmëruar futja e këtij projektligji në seancën e datës 18, në një kohë kur ne ende nuk e kemi shqyrtuar nen për nen. Më lejoni t'u them përfaqësuesve të djathtë të tërhiqemi për pak minuta, për të diskutuar këtë çështje.

Ju faleminderit!

Milva Ekonomi – Zoti Kostaq Papa, ju faleminderit për këtë ndërhyrje, por prisni t'ju sqaroj, përpara se të tërhiqeni!

Duhet të keni parasysh se në datën 18 është kalendari i Kuvendit dhe çdo komision është i detyruar të punojë sipas këtij kalendarit. Kështu që është rënë dakord që ky projektligj të lihet për datën 18 dhe ne duhet të punojmë sipas kalendarit. Për të kaluar në diskutimin nen për nen, që është një procedurë e vendosur nga mënyra se si punojnë komisionet e përhershme parlamentare, bëhen disa hapa.

Së pari, diskutohet projektligji në parim nga ata që janë nxitësit e tij, dhe ne i thirrëm ata këtu, në Komision. Këtë fazë e kemi kaluar dhe ramë dakord që t'i dërgonim një letër Këshillit të Ministrave për të thërritur në dëgjese të gjithë ata që janë të interesuar për këtë projektligj dhe përgjigjja erdhi brenda afatit kohor. Më pas, vendosëm të bënim dëgjesat, madje javën që kaloi ne i kryem të gjitha dëgjesat, si në orarin e paradites, ashtu dhe në atë të pasdites, morëm të gjitha shënimet e ardhura nga sekretarët e rektorateve apo nga rektorët në mënyrë të pavarur, morëm shënimet që kanë ardhur nga studiues të pavarur, si dhe dëgjuam edhe zotin Fuga, i cili na ka lënë këtu platformën e tij. Pas këtyre konsultimeve, kemi rënë dakord në këtë komision me votë për të pasur një relator dhe caktuam zotin Ismet Beqiraj, kemi caktuar

këshilltarin tonë juridik, kemi caktuar juristët që vinin nga Akademia e Shkencave dhe Ministria e Arsimit. Këta do të ulëshin e të konsolidonin të gjitha komentet. Jo çdo koment që bëjnë ata që janë të interesuar, mund të përfshihet në projektligjin që po diskutojmë sot, por do të jetë gjëja më e mirë, sepse siç keni ju qëllimin e mirë për të bërë një projektligj për shkencën, që t'i shërbejë të ardhmes së vendit, edhe kjo pjesë e kësaj tavoline ka qëllim të bëjë një projektligj që t'i shërbejë shkencës dhe Akademisë së Shkencës në Republikën e Shqipërisë. Ju mund të keni të drejtën të tërhiqeni, por duhet të dini se, pavarësisht nga kjo, ne kemi kuorumin dhe mund të vazhdojmë mbledhjen, por do të ishte në të mirë të punës të rrini të dëgjoni se si zhvillohen procedurat, sepse, duke marrë pjesë në komisione, do të kuptoni pak më mirë se si zhvillohet veprimtaria e tyre.

Faleminderit!

Kostaq Papa – A mund ta marr sërish fjalën?

Milva Ekonomi – Për procedurë keni të drejtë edhe dy minuta.

Kostaq Papa – Faleminderit!

Unë ju dëgjova me kujdes dhe nuk kam ndonjë mentalitet lidhur me ato që sugjeruat, por pavarësisht se ne nuk jemi një grup parlamentar i organizuar, duke ardhur këtu dhe duke qenë përballë një shumice votash, gjë që është e dukshme, kam përshtypjen se kemi nevojë për një konsultim mes nesh, për t'i dhënë ligjit mendimin tonë, që të hartojmë një ligj më të mirë dhe më të pranueshëm për të gjithë, si dhe për një mbarëvajtje në të mirë të punës shkencore të akademikëve tanë të nderuar. Me lejoni të largohem dhe të kthehem më pas në një kohë të dytë!

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Keni rastin që të bëni amendimet që doni, kështu që unë ju bëj edhe një herë thirrje të gjykoni se ky është momenti për të bërë amendimet.

Kostaq Papa – Unë po largohem dhe do të kthehem pas disa minutash.

Milva Ekonomi – Kolegë, a e keni të gjithë variantin integral?

(Mungesë incizimi.)

...të kalojë nen për nen, pra ato nene që janë marrë në konsideratë, si dhe sugjerimet për çdo nen që është marrë në konsideratë. Ndërkohë, Gazmendi i ka të gjitha sugjerimet, si dhe tabelën matricë të këtyre ndryshimeve, por do të ishte mirë t'u shpërndahej nga një kopje edhe atyre që janë mbështetësit tanë në këtë proces.

(Mungesë incizimi.)

A jemi të gjithë gati t'i hedhim një sy nenit 1 “Dispozita të përgjithshme”?

Besoj se e keni lexuar dhe e keni parë që nuk ka pësuar ndryshime.

Kush është dakord me nenin 1?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Objekti”.

Ka pësuar ndryshime.

A mund ta lexoni, zoti relator?

Ismet Beqiraj – Ndryshimi i objektit ka të bëjë me teknikën legislative të të shkruarit nga propozimi bazë. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rolit të Akademisë së Shkencave, i organeve të saj përbërëse dhe i atyre që veprojnë pranë saj, si dhe rregullimi i marrëdhënieve të Akademisë me institucionet e tjera të kërkimit shkencor dhe të politikave të zhvillimit të saj. Këtu është marrë në konsideratë edhe sugjerimi i propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Milva Ekonomi – Kush është dakord me këtë riformulim të objektit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendohet se ato kanë punuar për të arritur deri në këtë variant.

Neni 3.

A mund të bëj një sugjerim te ky nen?

Unë mendoj se projektligji, përveç qëllimit të objektit, duhet të ketë edhe vizionin. Mendoj që nenin 3 ta ndajmë në dy nene, nenin 3, ku pika 3/1 bëhet “Vizioni” dhe formulohet kështu: “Akademia është institucioni publik më i lartë, që përfaqëson dhe bart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë, debatit, bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh dhe krijuesish”. Ky të bëhet si vizion, kurse neni 4 të marrë titullin “Akademia” dhe aty të përfshihen pikat 2, 3 dhe 4 të nenit ekzistues 3. Pra, nuk ka asnjë ndryshim, vetëm se neni 3 ndahet në dy nene, “Vizioni” dhe “Akademia”.

Ismet Beqiraj – Te ky nen që u nda në mes, ka një ndryshim. Duke iu referuar pikës 3 të projektligjit ekzistues, është marrë propozimi i Këshillit të Ministrave “Akademia si person juridik përbëhet nga trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve”.

Milva Ekonomi – Kush është dakord me këto dy riformulime, pra të ndahet neni 3 në dy pjesë dhe neni 4, ku bëhet numërimi i ri, të marrë këtë ndryshim të Këshillit të Ministrave? Të rrijë siç është apo të ndahet?

Fadil Nasufi – Futja e termit “Vizion”, më duket pa vend, sepse nuk parashikon çfarë misioni, çfarë programi apo çfarë arritjesh do të realizojë Akademia. Kjo përcakton se çfarë

është Akademia, pra institucioni publik më i lartë. Kështu që termi “vizion” nuk ka nevojë të jetë, sepse vizioni është si e parashikon apo si e zhvillon Akademia të gjithë misionin e saj.

Milva Ekonomi – Kush është dakord që neni 3 të rrijë siç është? Kush është dakord që të ndahet në dy?

Miratohet varianti siç është.

Vaso Tole – Në rast se do ta votonim ndryshimin që “Akademia, si person juridik përbëhet nga trupa e shkencëtarëve dhe kërkuesve” pa plotësimin që në këtë ligj do të quhet asamble, na krijohet një problem i madh, sepse me këtë ne nënkuptojmë që të gjithë ata janë me titullin akademik. Kur thuhet “Asambleja e Akademisë” kuptohet që përbëhet nga anëtarë me tituj akademikë. Në rast se do ta lini “Akademia, si person juridik përbëhet nga trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve”, pa gjë tjetër, atëherë i bie që çdo shkencëtar dhe kërkues është anëtar i akademisë. Nëse nuk e doni termin “asamble”, të paktën ta lini me titullin “akademik”, se ndryshe nuk ka sens!

Milva Ekonomi – A jeni dakord me këtë plotësim?

Ismet Beqiraj – E keni dhënë si sugjerim, duke reflektuar edhe propozimet e Këshillit të Ministrave.

Milva Ekonomi – Dakord, miratohet neni 3 pa ndryshimet që u propozuan dhe shtohet ndryshimi që bëri zoti Tole.

Kalojmë te neni 4.

(Mungesë incizimi.)

Te neni 4 kam një propozim.

...domethënë, ndryshojnë numrat e neneve?

A jemi dakord me këtë renditje?

Miratohet.

Neni 5 “Roli dhe funksionet kryesore të Akademisë”.

Këtu ka ndryshime dhe plot propozime.

Çfarë mendimi ka relatori?

Ismet Beqiraj - ...te neni 4 me propozimin e ri, pra merret në konsideratë propozimi i Këshillit të Ministrave për pikën 5, ku riformulohet paragrafi “...të kontribuojë në promovimin e shkencëtarëve të rinj dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre”. Pika 7, duke marrë në konsideratë edhe propozimet e disa deputetëve, duhet riformuluar, duke pasur parasysh propozimin e deputetes Gjermani dhe akademikes Aurela Anastasi, sepse është më i saktë. Konkretisht te

pika 7 thuhet: “të botojë organe periodike dhe vepra të tjera me nivel të lartë ndikimi shkencor” që propozohen sipas propozimeve të kolegeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasil Tole – Trajnimi është jashtë funksioneve të Akademisë së Shkencave, por mund ta lemë pa i ndryshuar thelbin, pra: “të kontribuojë në promovimin e vazhdueshëm të shkencëtarëve të rinj” dhe jemi në rregull. Më mirë “mbështetje dhe promovim të vazhdueshëm të shkencëtarëve...” jo “trajnim”.

Milva Ekonomi - Pra, pika 7 të riformulohet sipas propozimeve të zonjave Gjermani, Anastasi dhe zotit Fuga. Po e lexoj edhe një herë: “Të promovojë, të botojë dhe të shpërndajë standardet e reja ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit, si dhe të garantojë respektimin e tyre për vlerësimin e punës shkencore dhe etikës në shkencë, si dhe për mbështetjen e programeve të studimit e kërkimit”.

A jeni dakord me këtë formulim?

Vasil Tole – Në rast se bëhet fjalë për të zëvendësuar pikën 7, thotë: “të botojë organet periodike dhe vepra të tjera”, ne nuk kemi kundërshtim, por kjo fjali të mos hiqet, pasi ky është detyrimi ynë bazik për të botuar vepra shkencore dhe organe periodike. Shtojeni edhe atë tjetrën në vazhdim.

Milva Ekonomi – Sipas vërejtjeve që ka bërë zoti Fuga fjalia “të botojë organe periodike...” duhet riformuluar.

Vasil Tole – Zonja Ekonomi, ne jemi të organizuar sipas fushave të shkencës. Nuk ka Akademi të Shkencave që për një fushë të rëndësishme shkencore të mos ketë organ periodik. Aktualisht, ne kemi dy organe periodike, që mbulojnë të dyja seksionet kryesore dhe nëse nuk e vendosim detyrimin që të kemi organe periodike dhe të botojmë vepra me nivel të lartë shkencor, ne nxjerrim jashtë loje dy funksionet kryesore të Akademisë: seksionet që botojnë vepra në organet periodike dhe këshillin e botimeve, i cili ekziston vetëm për të miratuar studimet dhe veprat shkencore më të mira vjetore në Republikën e Shqipërisë. Jam dakord që t’i shtoni ato gjërat e tjera, por këto të dyja të ngelen si funksionet bazë të Akademisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erzen Tola – Më falni, nëse mund të ndërhyj! Duke qenë se riformulimi lidhet me programin e studimit, ne do të donim ta shihnim të riformuluar, që ta diskutonim edhe një herë, duke marrë parasysh qëndrimet tona dhe të Këshillit të Ministrave për këtë çështje.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Dakord.

Fjalën e ka relatorit.

Ismet Beqiraj - ...të ish-nenit 5, pra nenit 4, lidhur me kriteret dhe metodat për matjen dhe vlerësimin objektiv të cilësisë dhe të kontributeve në procesin e kërkimit shkencor që bën Akademia e Shkencave, kërkohet të saktësohet se cila strukturë përgjegjëse mund t'i bëjë këto propozime. Ne parashikojmë, edhe për debat, që institucionet përgjegjëse të propozojnë metoda dhe kriteret për matjen dhe vlerësimin objektiv të cilësisë dhe kontributeve në procesin e kërkimit shkencor pranë ministrisë përkatëse, komisionit, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.

Milva Ekonomi – Personalisht nuk mendoj se Akademia e Shkencave, për mënyrën si do të bëjë kërkimin e vet, u dashka të marrë leje. Jo më kot ajo është akademi që bën kërkimin e vet dhe nxjerr produktin. Unë nuk e di, a mund t'ia miratojë njeri Akademisë së Shkencave kriteret e kërkimit?!

Vasil Tole – Me sa e kuptojmë ne, ideja është të propozojë për sistemin e kërkimit shkencor në Shqipëri. Duke qenë organi më i lartë, të propozojë metoda e kriteret për matjen. Kështu siç është, më duket korrekte, bashkë me shtesën që propozoi relatori. Është shumë normale që të specifikohen institucionet që propozojnë, pasi kjo na lehtëson, sepse e kemi më të qartë me kë do të komunikojmë. Nuk shoh ndonjë kontradiktë.

Milva Ekonomi – A ka ndonjëri nga kolegët ndonjë mendim?

Po, zoti Tola.

Erzen Tola – Faleminderit!

Në mënyrën si është organizuar kjo dispozitë, nënkuptohet që nuk është vetëm për kërkimin shkencor brenda Akademisë së Shkencave, por përtej saj dhe, duke pasur përsëri merakun e raportit me institucionet e arsimit të lartë dhe autonomisë që ato gëzojnë në përcaktimin e programeve të studimit dhe kriterëve të kërkimit shkencor, do të sugjerohet të rishikohet prapë kjo dispozitë, në kuptimin që të mos lihet e hapur. Për të gjitha institucionet kërkimore-shkencore, të përcaktohen kriteret e metoda dhe Akademia të bëjë vlerësimin e kërkimit shkencor. Mendojmë të rishihet, sepse ai është edhe propozim i Këshillit të Ministrave.

Vasil Tole – Është krijuar ideja sikur ne po hyjmë në një konflikt, ndërkohë që jemi shumë dakord me atë që thotë Këshilli i Ministrave, këtu bëhet fjalë për propozim dhe propozimi i drejtohet ministrisë, ministria e gjykon nëse vlen apo jo: nëse po, e aprovon; nëse jo, u thotë “faleminderit”. Bëhet fjalë për propozim metodash e kriteresh. Çfarë problemi ka me propozimin? Ku është ndërhyrja?

Pashë një kolege këtu që është e një OJF-je, e cila monitoron punën e komisionit dhe është e rëndësishme sa vlerësohet monitorimi që bën dikush, pra sa vlerësohet propozimi, por ne nuk i ndërhyjmë kujt, nëse propozon diçka. A e merr në konsideratë komisioni apo qeveria, e dinë ata, ne thjesht propozojmë, pra ngarkohemi me punë.

Milva Ekonomi – Po grupi nismëtar, a ka ndonjë ide për këtë?

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Meqenëse është pjesë e propozimeve të mia, përveç faktit që është në projektligjin ekzistues, dua të sqaroj kolegët e komisionit që nuk bëhet fjalë për prekje autonomie dhe nuk ka qenë asnjëherë qëllimi im. Megjithatë, unë mbështes idenë që Akademia, si institucion i lartë shkencor, duhet të jetë model dhe duhet të promovojë e të hartojë politika që nuk janë imponuese, por që mund të merren në konsideratë dhe realisht Akademia e ka bërë herë pas here ndër vite. Ndërkohë, ka bërë edhe rregullore për vlerësimin e punimeve shkencore, ka përpunuar standarde ndërkombëtare, të cilat i ka përkthyer dhe i ka vënë në zbatim për kërkimin shkencor, të cilat herë pas herë kanë munguar në Shqipëri.

Dua të theksoj se kur flasim për revista shkencore në Shqipëri, nuk ka standarde për vlerësimin e tyre. Vetë Akademia mund të hartojë politika dhe t'i prezantojë ato, ndërkohë ne jemi të bindur që kërkimi shkencor nuk është vetëm pronë e institucioneve të arsimit të lartë, sepse kërkim shkencorë bëjnë edhe ekspertët e pavarur, institucionet e ndryshme publike, të cilat mund të kenë nevojë për vlerësime apo kritere, por edhe organizatat e shoqërisë civile, që mund t'i përdorin këto si sisteme referimi. Unë nuk e shoh Akademinë si imponuese, por si në rolin e saj për të prezantuar këto kritere, të cilat mund të jenë në treg dhe mund t'i përdorin, ose jo të tretët.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Unë mendoj që nenin 12 ta miratojmë në parim, por para se të futet si pjesë integrale e ligjit, të shihet nga Ministria e Arsimit, pasi ta riformulojmë.

Fjalën e ka relatori.

Ismet Beqiraj – Lidhur me pikën 13 të nenit që po diskutojmë, merret në konsideratë edhe propozimi i Këshillit të Ministrave që fjalët: “të analizojë arritjet dhe problematikat e këtyre kërkimeve dhe të hartojë çdo dy vjet një raport publik për to” të dalë si një fjali më vete. Po ta shihni, te drafti është paragrafi i dytë i pikës 13, te pjesa e ligjit integral, kolona djathtas.

Milva Ekonomi – A do të rrijë kjo pjesa e dytë, që keni nënvizuar, si pika 13 apo do të bëhet pika 14?

Ismet Beqiraj - Jo, kjo është brenda kësaj pike, me një fjalë, rri si paragraf i dytë.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me këtë riformulim?

Ismet Beqiraj – Pika 13 është sikurse te projektligji, vetëm se kjo është një fjali e gjatë dhe vihet pikë te gjysma e fjalisë: “të orientojë fushat dhe nënfushat prioritare në bashkëpunim me ministrinë për shkencën, për kërkimet shkencore të doktoratës”, kurse paragrafi i dytë thotë: “të analizojë arritjet dhe problematikat e këtyre kërkimeve dhe të hartojë çdo dy vjet një raport publik për to”.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me këtë ndryshim?

Miratohet.

Pika 14.

Ismet Beqiraj – Edhe të pika 14 merret në konsideratë propozimi i Këshillit të Ministrave. Kjo riformulohet kështu: “Të inkurajojë si prioritet të kërkimit shkencor zhvillimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor dhe të mbrojë deontologjinë e tij”.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me propozimin e Këshillit të Ministrave?

Dakord.

Miratohet.

Kemi edhe dy propozime që kanë ardhur nga zonja Gjermani.

Ismet Beqiraj – T’i mbaroj këto dhe t’i them pastaj propozimet.

Milva Ekonomi – Dakord.

Ismet Beqiraj – Lidhur me pikën 15, edhe unë, si relator gjatë dëgjësave kam qenë në një mendje me sugjerimin e Këshillit të Ministrave dhe me ato të aktorëve të tjerë për heqjen e kësaj pike, ku thuhet: “të monitorojë procesin kërkimor, që realizohet në rrjetet e institucioneve publike dhe të botojë rezultatet e këtij monitorimi”.

Milva Ekonomi – A jeni dakord që të hiqet?

Dakord.

Mos harroni se te pika 15 që po heqim, duhet të theksojmë se marrim në konsideratë edhe opinionin e rektorëve, të cilët i kishim këtu në dëgjësë!

Pika 16.

Ismet Beqiraj – Pas pikës 15 të shtohen edhe këto pika të tjera, pika 16, që është propozim i Këshillit të Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po flas për këtë terminologji, që të mos ngatërrohem. Pra, “...të promovojë identitetin kombëtar nëpërmjet përafrimit gjithmonë e më të ngushtë me akademitë shqiptare në rajon, veçanërisht me Akademinë e Shkencave të Kosovës”.

Milva Ekonomi – A jeni dakord?

Shaban Sinani – Faleminderit!

Mendoj se pjesa e fundit është kufizuese, veçanërisht pjesa “me Akademinë e Shkencave të Kosovës”, sepse anëtarë të Akademisë së Shkencave ka edhe në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

Për sa i takon shqetësimit specifik për këtë, në pikën 3 të nenin pasardhës, thuhet: “Personat me origjinë shqiptare, që janë me të drejta të plota të një akademie pjesëtarë të "All European Academies", fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë”. Kështu që ky nen është më përfshirës, sepse u referohet anëtarëve të akademive të shkencave kudo ku janë, anëtarëve të organizatës më të madhe ndërakademike europiane, që janë në Kosovë, në Maqedoni, në Malin e Zi, por edhe në vende të tjera. Pra, mund të hiqet specifikimi “veçanërisht”, sepse është kufizues.

Milva Ekonomi – A jeni dakord që të miratohet pika 16 me këto ndryshime?

Erzen Tola - Atëherë, po e ritheksoj edhe një herë propozimin e bërë nga Ministria e Arsimit nëpërmjet Këshillit të Ministrave, i cili ka të bëjë me bashkëpunimin institucional të akademive shqiptare të rajonit. Pra, nuk ka të bëjë me individët kërkues shkencorë akademikë, të cilët mund të jenë anëtarë të Akademisë së Shkencave për shkak se janë anëtarë në "All European Academies", por ka të bëjë me bashkëpunimin institucional, që duhet të jetë detyrim ligjor i Akademisë së Shkencave. Pikërisht për këtë çështje është bërë ky propozim në pikën 16.

Vaso Tole - Ju lutem, unë kam vetëm një mendim.

Në rast se do të lihet “...në Akademinë e Shkencave të Kosovës”, emërtimi zyrtar është “Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës”.

Shaban Sinani – Sërish do të krijojmë një problem me akademitë e tjera.

(Diskutime pa mikrofon.)

Shaban Sinani – Më lejoni edhe një herë të them se formulimi ashtu siç është e copëton hapësirën historike, ku objekt interesi është identiteti kombëtar. Mendoj se ajo pjesë duhet të hiqet dhe nuk ka specifikime për veçanësinë e një pjese ndaj një pjese tjetër. Neni në vijim ka një formulim gjithëpërfshirës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Po te ky nen, Këshilli i Ministrave shton edhe një pikë tjetër, që ka të bëjë me barazinë gjinore, por unë, si relator, mendoj dhe sugjeroj që në këtë pikë mund ta kalojmë te neni 6. Mund ta miratojmë fillimisht, por ka edhe propozime të tjera. Varianti i

Këshillit të Ministrave është: “...t’u garantojë grave mundësi të barabarta në anëtarësi dhe debate shkencore, me synim përfshirjen e tyre sa më të gjerë dhe cilësore në instancat vendimmarrëse kërkimore brenda Akademisë.”

Milva Ekonomi – Po, zoti Vasil.

Vasil Tole – Siç e kemi theksuar, jemi shumë dakord me këtë gjë, por nuk mund t’ua sigurojmë këtë të gjitha grave. Pra, ose do të bëhet “për shkencëtarët gra” ose “për gratë shkencëtare” dhe unë e di se si mund ta formulojmë. Pra, duhet ta bëjmë “t’u garantojë grave shkencëtare” ose “shkencëtareve gra”. Si mund ta bëjmë më të saktë?

Milva Ekonomi – Nga grupi nismëtar kemi një propozim që ka ardhur nga zonja Gjermani. A mund të na e lexoni?

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, zonja Anastasi dhe zonja Gjermani kanë bërë një propozim lidhur me këtë pikë.

Ismet Beqiraj - Propozimi i deputetes Gjermani është: “Zgjedhja e anëtarëve të Asamblesë zhvillohet në përputhje me parimin e barazisë gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit”.

Vasil Tole – Edhe me këtë formulim biem dakord, por kjo ka të bëjë me zgjedhjet për në asamble, kurse këtu është një funksion bazë i Akademisë, sepse ne nuk kemi vetëm asamble, por kemi, për shembull, Akademinë e të Rinjve, ku përsëri është çështja e barazisë gjinore...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, por që të dyja kanë kuptim dhe nuk e konkurrojnë njëra-tjetrën, sepse njëra qëndron si rol, kurse tjetra ka të bëjë me procedurën.

Shaban Sinani – A mundet që formulimi të evitojë theksimin e fjalës “grave” dhe të jetë: “...të garantojë mundësi të barabarta gjinore në anëtarësi”, pa e veçuar në një mënyrë specifike?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, le të jetë: “...të garantojë mundësi të barabarta gjinore në anëtarësi dhe në debatin shkencor.”

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Këtu thuhet: “Në përputhje me parimin e barazisë gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit”.

Zonja Gjermani në kërkesë ka bërë një formulim, ku e vendos theksin tek anëtarësimet, por mbase ne mund ta huazojmë këtë shprehje. Pra, këtu thuhet: “...në përputhje me barazinë

gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit”. Pra, mund ta vendosim edhe këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Domethënë, le ta riformulojmë këtë nen me propozimin e zonjës Gjermani dhe të biem dakord që ta vendosim te pika 17. Për këtë nen kemi disa formulime.

Zoti Ismet, a keni për të shtuar diçka, sepse këtu kanë ardhur edhe dy propozime të tjera?

Ismet Beqiraj - Zonja Gjermani ka edhe disa propozime të tjera, ku kërkon riformulimin e të gjitha pikave të nenit që sapo diskutuam.

Milva Ekonomi – Po, i hoqëm ato, i vendosëm.

Ismet Beqiraj – Duke marrë në konsideratë që shumë nga këto propozime, edhe në gjykimin tim si relator...

Milva Ekonomi – Ne vendosëm për dy gjëra të reja.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, sepse edhe unë këtë gjë do të propozoj!

Pra, pjesa dërrmuese e këtyre është ezauruar, ndërsa na mbetet për të diskutuar riformulimin e bërë nga zonja Gjermani për pikat 5 dhe 6, që kanë të bëjnë me promovimin e standardeve të reja ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe të informacionit...

Milva Ekonomi – E kemi vendosur këtë gjë.

Pra, edhe propozimin e zonjës Anastasi, edhe propozimin e zotit Fuga i mbledhëm në një definicion të vetëm dhe ramë dakord që ta bënim kështu. Para se ta vendosim plotësisht, zoti Erzen do ta shikojë edhe një herë formulimin juridik që kemi bërë. A biem dakord për këtë gjë? Dakord.

Te lista e zonjës Gjermani janë edhe dy propozime të tjera, që lidhen me albanologjinë dhe gjuhën shqipe. A do t'i vendosim këto dy propozime, apo jo?

Ismet Beqiraj – Propozimi është për pikën 3, ku thuhet: “...të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për integrimin në gjuhën shqipe, të terminologjive bashkëkohore të shkencës dhe të teknikës, si dhe për konsolidimin e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e shkencës”. Kjo është pika e parë dhe unë si relator jam dakord. Para se të kaloj te pika tjetër, kërkoj që komisioni të japë një mendim për pikën e parë.

Milva Ekonomi – A e dëgjuat ju, përfaqësues të Akademisë, propozimin që ka ardhur?

Shaban Sinani – Vetëm për shprehjen “integrimin në gjuhën shqipe” kemi një rezervë. Termi duhet të jetë “...për përdorimin e njësuar në funksionet zyrtare të gjuhës shqipe”, sepse termi “integrim” nuk shkon në proceset gjuhësore që zhvillohen.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Kemi edhe pikën tjetër, që është: “...të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për zhvillimin e shkencave të albanologjisë dhe për promovimin e arritjeve të tyre brenda dhe jashtë vendit.”

Ismet Beqiraj – Unë, si relator, propozoj që edhe kjo pikë të përfshihet te funksionet dhe te roli i Akademisë.

Milva Ekonomi – Dakord!

Domethënë, një pikë e hoqëm dhe nga 17 pika, mbetën 16. Gjithashtu, kemi shtuar edhe dy pika të tjera dhe gjithsej u bënë 18. Tani do t’i rikthehemi edhe një herë definicionit në pikën e vjetër 16: “...të promovojë identitetin kombëtar”.

A jeni dakord në këto kushte që ta lëmë “deri në rajon”? Dakord!

Miratohet.

Kalojmë te neni 5 “Përbërja e Akademisë”.

Ismet Beqiraj – Te përbërja e Akademisë, ka vetëm një ndryshim në rreshtim, që është: “Asamble”, “Kryesi” dhe “Kryetar”.

Milva Ekonomi – Pra, renditja është “Kryetar” dhe më pas “Kryesi”, kurse tani propozohet që të jetë “Kryesi” dhe më pas “Kryetar”. A biem dakord për këtë ndryshim? Dakord!

Miratohet.

Kalojmë te kreu i dytë, neni 6 “Asambleja”. Atëherë, ne do të lexojmë emërtimet e vjetra, sepse të gjitha do të rregullohen pas ndryshimeve që do të bëjmë.

Po, relatori.

Ismet Beqiraj – Lidhur me pikën 1, të nenit 6, nga Këshilli i Ministrave nuk del qartë se sa është numri i përgjithshëm i asamblesë. Opinioni im, si relator, është që të mbetet kështu, pasi është e qartë.

Milva Ekonomi – A jeni dakord? Dakord!

Miratohet.

Kalojmë te pika 2.

Ismet Beqiraj – Jam i mendimit që edhe pika 2 të mbetet ashtu siç është, por lidhur me shprehjen “në procedurat e kandidimit dhe të përzgjedhjes të mbahen parasysh kuotat gjinore në bazë të specifikimeve të procesit...”

Milva Ekonomi –Pra, e vendosëm tek Asambleja.

Ismet Beqiraj – Në qoftë se e kemi vendosur atje, besoj se këtu duhet hequr.

Milva Ekonomi –Këtu nuk e kemi, por do të heqim edhe diçka tjetër te pika 5, që keni propozuar ju, ku thuhet: “Personat e zgjedhur sipas këtij neni quhen “Anëtarë të Asamblesë”, sepse e kemi futur te neni tjetër.

Ismet Beqiraj – Do ta them në fund këtë pikë, por po i marr sipas radhës. Atëherë, meqenëse u miratua te roli dhe funksionet e Akademisë, paragrafi “në procedurat e kandidimit dhe të përzgjedhjes mbahen parasysh kuotat gjinore në bazë të specifikave të procesit” duhet të hiqet.

Milva Ekonomi – Në rregull, që të vazhdojnë të kenë vijueshmëri tek të gjithë paragrafët e neni.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Lidhur me pikat e tjera propozoj që të mbeten ashtu siç janë, vetëm me një ndryshim te rreshtimi, ku pika 4 bëhet 5 dhe pika 5 bëhet 4. Lidhur me pikën e fundit, ku thuhet: “Personat e zgjedhur sipas këtij neni quhen “anëtarë të Akademisë””, mendoj se tani duhet të quhen “anëtarë të Asamblesë”.

Milva Ekonomi – Kjo pikë ka rënë, sepse e kërkoi zoti Tola që ta vendosnim pikën 3 te neni 3.

Shaban Sinani – A mundem?

Milva Ekonomi – Po, patjetër!

Shaban Sinani – Nuk e dimë arsyen pse ka rënë një pjesë e formulimit në paragrafin 3 siç është në projekt, por është diçka e rëndësishme, që duhet të theksohet, sepse ka të bëjë me numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Akademisë së Shkencave. Është e saktë që numri i anëtarëve të jashtëm është deri në 10, i anëtarëve të nderit deri në 15 dhe i anëtarëve korrespondentë deri në 15.

Efekti i menjëhershëm i këtij ligji është që 8 anëtarët që ka sot Akademia e Shkencave do të marrin menjëherë statusin e anëtarëve korrespondentë, sepse nuk ushtrojnë të drejtën e votës, për shkak të të qenit rezidentë të përhershëm në një shtet tjetër.

Pra, numri i anëtarëve të jashtëm është deri në 10, ai i anëtarëve të nderit deri në 15 dhe i anëtarëve korrespondentë deri në 15.

Ismet Beqiraj – Kjo thuhet këtu dhe kështu do të mbetet: “Numri i anëtarëve të jashtëm është deri në 10, ai i anëtarëve të nderit deri në 15 dhe i personave të tjerë me origjinë shqiptare...”

Milva Ekonomi – Te varianti i propozuar kjo ka rënë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Edhe te varianti i paraqitur nga grupi nismëtar, kjo pjesë e anëtarëve korrespondentë nuk është. Pra, nëse do të shikoni në anën e majtë të matrices, do të vini re se kjo nuk është.

Ismet Beqiraj – Pikërisht këtë pjesë unë po e krahasoja me projektligjin që na ka ardhur dhe që është publikuar në faqen e Kuvendit, dhe nuk është në variantin final, që na ka ardhur nga grupi nismëtar. Nuk e di nëse është bërë ndonjë gabim teknik, apo jo.

Shaban Sinani – Këtu ka një humbje të tekstit në proces e sipër, por është shumë e qartë që nuk ka ardhur kështu, por mospërcaktimi i numrit të anëtarëve korrespondentë do të bëjë që ligji të ketë mangësi. Pra, duhet lënë siç është përcaktuar: numri i anëtarëve të nderit, të jashtëm, korrespondentë dhe të meritës.

Milva Ekonomi - Duhet shtuar edhe kjo kategori, sepse nuk ka qenë dhe është e nevojshme që të jetë tani.

Shaban Sinani – Menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, një pjesë e anëtarëve të Akademisë së Shkencave, të cilët janë rezidentë në një vend tjetër në mënyrë të përhershme, duhet të zgjedhin nëse do të vijnë në Shqipëri të ushtrojnë të drejtën e votës dhe të drejtën e anëtarësisë në Asamble apo do të kalojnë në statusin e akademikëve korrespondentë, ashtu siç janë edhe tani.

Milva Ekonomi – Kjo pjesë duhet parë përsëri, sepse duhet të bëjmë përmirësime jo vetëm këtu, por edhe tek anëtarësia.

Erzen Tola – Më duhet të shtoj diçka lidhur me këtë nen dhe me komentet që kanë ardhur nga Këshilli i Ministrave. Duke qenë se në të gjithë nenin përcaktohen numrat “deri në”, që do të thotë se mund të jenë edhe 8, 9 apo 10 e kështu me radhë...

Milva Ekonomi – Maksimumi, ai është tavani.

Erzen Tola - Maksimumi do të jetë shumë i vështirë për t’u llogaritur nesër, gjatë zbatimit të kuorumit për vendimmarrje të nevojshme. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse ne e kemi komentuar. Megjithatë, në cilësinë e ekspertëve mendojmë se kemi ardhur këtu për të ndihmuar procesin. Kjo është një pjesë që duhet ta diskutojë vetë Akademia.

Shaban Sinani – Dua të jap një shpjegim në lidhje me këtë shqetësim. Kuorumi u referohet vetëm anëtarëve akademikë dhe akademikë të asociuar, që do të thotë 30 plus 10. Pra, kuorumi i referohet shifrës 40 që kanë votë detyruese.

Milva Ekonomi – Pra, atyre që janë...

Shaban Sinani – Jo, vetëm atyre që janë anëtarë ose anëtarë të asociuar.

Milva Ekonomi – A jeni dakord që ta përfshijmë edhe këtë kategori të re të propozuar në këtë moment? Nuk po shikoj asnjë dorë të ngritur kundër, kështu që miratohet.

Në pikën e fundit e këtij neni, që i bie të jetë pika 5 ose 6 thuhet: “Personat e zgjedhur sipas këtij neni quhen “anëtarë të Asamblesë””. A do të qëndrojë kjo pikë apo do të bjerë, sepse e kemi vendosur te pika 3 e nenit 3?

Ismet Beqiraj – Propozimi është që të qëndrojë, por jo të quhen “anëtarë të Akademisë”, por të quhen “Anëtarë të Asamblesë”, sepse bie ndesh me pikën 1 të nenit 7 “Detyrat e Asamblesë”, ku thuhet: “...zgjedh anëtarët e Akademisë”. Pra, Asambleja zgjedh anëtarët e Akademisë dhe kështu automatikisht merr titullin akademik.

Milva Ekonomi – Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7 “Detyrat e Asamblesë”.

Ismet Beqiraj – Te neni 7, “Detyrat e Asamblesë”, merret në konsideratë propozimi i Këshillit të Ministrave, ku sugjerohet që të plotësohen pikat 3 dhe 4.

Në pikën 3 thuhet: “Miraton projektbuxhetin vjetor, pas përgatitjes së tij nga Kryesia”.

Në pikën 4 thuhet: “Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Akademisë për vitin përmyllës, pas përgatitjes së tij nga Kryesia”. Edhe pse diku në nenet përkatëse kjo shtesë togfjalëshi është, por ajo duhet të ritheksohet në mënyrë që të mos quhet si apendiks.

Gjatë diskutimit që kemi bërë së bashku me juristin lidhur me pikën 7, ne kërkojmë një sqarim, ku thuhet: “Miraton apo ratifikon projektligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Akademinë e Shkencave”, si dhe marrëveshjet që nënshkruan Akademia me të tretët, sipas përcaktimeve në statut”. Kjo pikë është për t’u debatuar dhe debati qëndron te fakti nëse ka të drejtë apo jo Akademia të miratojë dhe të ratifikojë projektligje. Unë ia lë komisionit për ta diskutuar.

Milva Ekonomi – Unë do të shtoj diçka dhe, më pas, po ia kaloj fjalën këshilltarit.

Akademia nuk mund të bëjë propozime për ndryshim ligji, nuk e ka këtë tagër. Këtë tagër e kanë deputetët, e ka Këshilli i Ministrave dhe 20 mijë zgjedhës. Pra, akademikët nuk e kanë këtë tagër, kështu që besoj se kjo pikë nuk mund të qëndrojë.

Po, Gazi.

Gazmend Bici - Siç e thatë edhe ju, zonja Ekonomi, pika 7, për mendimin tim, absolutisht nuk duhet të qëndrojë, sepse këtë të drejtë kushtetuese e kanë vetëm deputetët, Këshilli i Ministrave dhe 20 mijë zgjedhës, dhe nuk mundet në asnjë rast që Akademia e Shkencave apo ndonjë institucion tjetër të imponojë apo të pengojë iniciativën e çdo deputeti, të Këshillit të Ministrave për të marrë një nismë legjislative për ndryshimin e ligjit të saj; më duket e papranueshme dhe antikushtetuese.

Vasil Tole – Prandaj, ndonjëherë gjuha shqipe nuk është e zonja për t'i shprehur të gjitha. Qëllimi këtu nuk është që Akademia dhe Asambleja të ketë nisma ligjore për të bërë projektligje, por qëllimi është që, pasi është marrë një nismë për të ndryshuar një gjë, ne të kemi një filtër për ta kaluar atë propozim në Asamble. Ky ka qenë qëllimi ynë kur e kemi hartuar këtë pikë, por në rast se nuk është shprehur qartë, është tjetër gjë. Ja ku jemi në rastin konkret: Asambleja është shprehur për projektligjin që ne po diskutojmë sot dhe ne këtë kërkojmë që, kur të vijmë këtu, anëtarët përfaqësues...

Milva Ekonomi – Por ju nuk mund të vini vetë këtu.

Vasil Tole - Pasi të na thërrisni ju, kjo është ideja.

Milva Ekonomi – Nëse nuk e merr përsipër iniciativën Këshilli i Ministrave, deputeti

...

Vasil Tole - Dakord! Ne duam që Asambleja të jetë organi që në një lloj kuptimi të shprehet për atë që është bërë sipas ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na falni, në rast se nuk është thënë në mënyrën e duhur, por qëllimi është që pasi ju të na ftoni, ne të vijmë këtu me një mendim të Asamblesë për ato ndryshime që janë propozuar, siç e thoni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, por këtu duhet të vijë Asambleja dhe jo vetëm unë dhe zoti Shaban.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Si në rastin konkret të këtij projektligji, donte ta bënte Asambleja e Akademisë së Shkencave, por, mbi të gjitha, u kërkohej korrespondencë e gjatë me Ministrinë e Arsimit, që të krijohej një komision.

Milva Ekonomi – Problemi është se këtë të drejtë ata e kanë, por kjo gjë duhet shprehur këtu, sepse këtë e keni në statut dhe nuk mund të bëhet me ndryshimin që kërkon.

Shaban Sinani – A mund të them diçka?

Milva Ekonomi – Patjetër!

Shaban Sinani – Ndoshta mund të ruajmë vetëm pjesën e dytë të kësaj pike, pra të drejtën që Akademia e Shkencave nënshkruan marrëveshje me të tretët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Këtë e rregullojmë te pjesa tjetër.

Erzen Tola – Mund të shtoj diçka, sepse pjesa e dytë e paragrafit nuk lidhet me të drejtën e nënshkrimit, por lidhet me të drejtën e ratifikimit nga Asambleja të marrëveshjeve të nënshkruara. Kështu që duhet riformuluar dhe duhet lënë gjysma e pikës 7.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vetëm për marrëveshjet e nënshkruara nga Akademia, pra nënshkruhet nga kryetari i Akademisë dhe kalon për miratim ose ratifikim në Asamble. Pra, mendoj se kjo gjë mund të mbetet dhe ky është si sugjerim.

Vasil Tole – Dakord! Mendoj që të lemë vetëm fjalinë e dytë: “...miraton marrëveshjet që nënshkruan Akademia me të tretët, sipas përcaktimeve në statut” dhe kjo të jetë pika 7.

Milva Ekonomi - Pra, “...miraton dhe ratifikon marrëveshjet që nënshkruan Akademia me të tretët, sipas përcaktimeve në statut”.

Gazmend Bici – Po pse duhet të jenë të dyja termat, edhe “miratim”, edhe “ratifikim”? Mendoj të jetë vetëm termi “miratim”, sepse ratifikimi bëhet në parlament.

Milva Ekonomi – Atëherë: “...miraton marrëveshjet që nënshkruan Akademia me të tretët, sipas përcaktimeve në statut”. A jeni dakord që të jetë e formuluar kështu kjo pikë e nenit? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 8. A ka ndonjë ndryshim?

Ismet Beqiraj – Te neni 8 unë vetë, si relator, kam një propozim, sepse nuk është e qartë. Te pika 6 e këtij neni thuhet: “Zgjedhjet për personat që ushtrojnë kompetencat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 7 të këtij ligji, bëhen me votim të fshehtë dhe me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve”. Këtu nuk përcaktohet sa është shumica absolute, 2/3-at apo 3/5- at. Unë propozoj që të zgjidhet njëri prej këtyre dy varianteve : 2/3-at ose 3/5- at.

Në terminologji ne kemi votim me shumicë të thjeshtë, votim me shumicë të cilësuar dhe votim me shumicë absolute. Vërtet këtu thuhet: “...me shumicë absolute”, por sa është masa reale?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, është në dy tri-nene një propozim i tillë, që është lënë me shumicë absolute, por nuk përcaktohet se sa është kjo shumicë!

Shaban Sinani – Shumica absolute është koncept i përkufizuar. Është 50+1. Çdo numër mbi gjysmën përbën shumicën absolute. Në rastet kur kërkohet shumicë e cilësuar, përcaktohet se cila është shumica e cilësuar.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj– Ju lutem, ta ndajmë!

Në qoftë se Akademia e ka asamblenë me 40, 44 apo 60 vetë, atëherë duhet të ketë 60,30,31... është në një votim...

Milva Ekonomi – E ndamë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Është koncept për të cilin është rënë dakord që në krye të herës.

Dakord, këtu nuk kemi ndryshime.

Neni 8. A jeni dakord të mbetet kështu siç është? Kush nuk është dakord, të ngrerë dorën.

Miratohet.

Neni 9, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të asamblesë.

Ismet Beqiraj – Të reflektohet sugjerimi nga Këshilli i Ministrave për nenin 9, ku thuhet se nevojitet të shtohet që anëtarët e asamblesë kanë këto të drejta dhe detyra. Të shtohet edhe kjo fjali, para se të fillosh, se ka filluar “të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të asamblesë” dhe kanë filluar pikat 1,2,3...

Te pika 4 e nenit 9, të reflektohet përsëri propozimi i Këshillit të Ministrave, konkretisht: “Të zbatohet detyrat që i janë dhënë nga asambleja, kryesia, kryetari, kryetarët e seksioneve apo kryetari përkatës”.

Milva, t’i kalojmë një nga një këto?

Milva Ekonomi- Po, aty ku ka ndryshime, se shoh që ka ndryshime.

Ismet Beqiraj – Pika 6 “Të kërkojnë dhe të marrin informacione për punë shkencore, plane dhe programe”, propozoj të hiqet.

Milva Ekonomi – Të hiqet pika 6? Dakord.

A mund t’i hedhim në votim këto që kanë ndryshime të mëdha? Pra, a jeni dakord që pika 4 të ketë këtë riformulim? Kush është dakord?

Miratohet.

Për pikën 6, që kërkohet të hiqet komplet në këtë nen....

Po, Vaso.

Vasil Tole - Problemi është që të gjitha këto që po i ndërtojmë si ura me universitetet, po na priten. Po zgjerojmë sensin e bashkëpunimit, por nuk kemi asnjë mundësi ku t’i kapim fjetet e bashkëpunimit.

Çfarë thotë 6-a? Të kërkojnë dhe të marrin informacion për punët shkencore. Si do ta marrim ne informacionin, në rast se do të bëjmë raporte ose në rast se nuk është e shkruar këtu?

Çfarë është kërkimi i informacionit? “Ju lutem, zoti rektor, na vini në dispozicion një informacion në lidhje me ecurinë, fjala vjen, e kërkimit shkencor gjatë vitit në vazhdim!” Çfarë është kërkimi i informacionit?!

Po, të lutem!

Shaban Sinani– Sapo është miratuar një nen, ku Akademisë së Shkencave i është njohur e drejta të propozojë fusha dhe nënfusha për studimet e shkallës doktorale. Pa e parashikuar edhe të drejtën për të marrë informacion, kjo do të ishte e pamundur, së paku për këtë pjesë të detyrës së saj. Janë në koherencë dy nene. Nuk preket autonomia universitare. Është një partneritet krejt i justifikuar, për shkak të funksioneve.

Milva Ekonomi- Po, Erzen.

Erzen Tola – Për sa i përket propozimit që ka bërë Ministria e Arsimit dhe Këshilli i Ministrave, kemi propozuar heqjen e kësaj pike, për shkak se marrja e informacionit është e drejtë dhe detyrë për çdo institucion shtetëror, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative. Pra, asnjë institucion nuk mund t’i refuzojë një institucioni tjetër marrjen e një informacioni konkret, ndërsa e parashikuar në këtë projektligj, si e drejtë e asamblesë për të kërkuar informacione, plane mësimore e kështu me radhë, konsiderojmë që vjen në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë dhe autonominë e universiteteve.

Milva Ekonomi- Kush është dakord të hiqet kjo pikë e nenit?

Kush është dakord të jetë kjo pikë?

Atëherë, me miratimin e votave të komisionit, kjo pikë rrëzohet.

Pika 7.

Ismet Beqiraj – Në pikën 7, si kudo, edhe në këtë projektligj, fjalët “institucione shtetërore publike”, të shkruhen “institucione publike”.

Milva Ekonomi – Vetëm riformulim.

Ismet Beqiraj – Po.

Milva Ekonomi – Për riformulimin e pikës 7, “institucionet publike”, besoj se të gjithë jemi dakord.

Pika 8.

Ismet Beqiraj – Për sa i përket pikës 8, për të cilën ka pasur shumë debate për shkeljen e ligjit për institucionet e arsimit të lartë, për pjesëmarrjen e anëtarëve të asamblesë në senatat e Akademisë dhe komisionet e përhershme të institucioneve publike të arsimit të lartë, ka mendime të hiqet, por ka edhe mendime të mos hiqet. Unë, si relator, edhe në përgjigjen që mora nga ministrja kur e thirrëm në dëgjuesë, përsëri ju propozoj të kemi një qasje për hapjen e

Akademisë drejt institucioneve të kërkimit shkencor dhe institucioneve të arsimit të lartë, duke mos cenuar aspak të drejtat ligjore.

Është bërë ky propozim: “Kanë të drejtë të marrin pjesë (është pika 8) në senatet e akademike dhe komisionet e përhershme të institucioneve publike të arsimit të lartë apo në institute ku ushtrojnë veprimtaritë e tyre, apo e kanë ushtruar për një kohë të gjatë (pra, ai akademik që është në x universitet) në një prej tyre, si anëtar *ex officio*, pa të drejtë vote.”

Këtë argument, edhe si relator, e mbështes në disa fakte: së pari, në të drejtën që u ka dhënë instituteve të kërkimit shkencor dhe institucioneve të arsimit të lartë projektligji për Akademinë e Shkencave, pikërisht në nenin 6, pika 2, për pranimet, ku thuhet: “Në procedurat e kandidimit dhe të përzgjedhjes (sapo e miratuar), përfshihen edhe struktura apo përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor të arsimit të lartë dhe të kulturës”. Së dyti, në nenin 18, pika 2, që ka të bëjë me përbërjen e komisioneve, ku në përbërjen e komisioneve ka si anëtarë, përveç akademikëve që janë zgjedhur, edhe përfaqësues të institucioneve dhe qendrave të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë. Së treti, në nenin 21, pika 2: “Në mbledhjen e saj vjetore për miratimin programit marrin pjesë aktive, me ftesë të kryesisë, përfaqësues të institucioneve kryesore të kërkimit, të ministrisë përgjegjëse për shkencën dhe të Këshillit të Ministrave.” Pra, janë të përfshirë... Për të qenë *fair* dhe për të thënë të vërtetën, për këtë marrëdhënie dhe bashkëpunim, se bashkëpunimi duhet të jetë reciprok dhe i balancuar nga të dyja anët, bëj këtë propozim dhe kërkoj që komisioni...

Milva Ekonomi – Të dëgjojmë zotin Tola dhe pastaj...

Nga propozimi nuk ka lëvizur ndonjë gjë, por mbase Erzeni duhet të na shpjegojë diçka, sepse ka...

Erzen Tola – Faleminderit!

Ministria e Arsimit, nëpërmjet Këshillit të Ministrave, është shprehur për heqjen e pikës 8, për arsyen e vetme se në ligjin e arsimit të lartë, si senatet akademike, ashtu edhe komisionet e përhershme, janë organe të brendshme të institucioneve dhe anëtarët zgjidhen në këto organe. Pra, ndiqet një proces zgjedhor për të qenë anëtarë në këtë komision. Duke qenë se janë organe të brendshme dhe vendimmarrja u përket vetëm institucioneve, anëtarët e këtyre organeve janë të brendshëm, të vetë institucionit.

Për sa i përket marrjes pjesë pa të drejtë vote, sipas propozimit të relatorit, konsideroj që nuk është me vend, pasi këto mbledhje bëhen gjithmonë të hapura dhe nuk bëhen asnjëherë me dyer të mbyllura. Në mbledhjet e këtyre organeve çdo palë e interesuar mund të marrë pjesë pa të drejtë vote, prandaj kemi propozuar heqjen e kësaj pike.

Milva Ekonomi – Urdhëroni!

Shaban Sinani – Jemi të mendimit që kjo pikë është shtuar për paritet të drejtash, siç u theksua nga zoti relator. Rrjetit arsimor universitar i janë njohur një sërë të drejtash, duke përfshirë atë që është më e rëndësishmja, fillimin e procedurës së promovimit të kandidatëve për anëtar të Akademisë së Shkencave dhe certifikimin e veprimtarisë dhe meritave të tyre shkencore. Pra, jo për të barazuar të drejtat, por duke qenë se kjo procedurë nis në njësitë themelore dhe në senat, prania e anëtarit të Akademisë së Shkencave, që e ka zhvilluar veprimtarinë e vet shkencore në njësinë ku promovohet kandidati i ri, qoftë edhe pa të drejtë vote, por më mirë do të kishte qenë me të drejtë vote këshillimore, unë mendoj se krijon një balancë të të drejtave dhe përgjegjësie.

Milva Ekonomi – Urdhëroni!

Vasil Tole – Mua më bën përshtypje ngutësia e Ministrisë së Arsimit për të mos i ndërtuar këto komunikime. Unë kam këtë arsytim: në ligjin “Për arsimin e lartë” në një nga pikat e përkufizimeve, ndër të tjera, trajtohet edhe titulli “Akademik”, pra, ndër të tjera thuhet edhe çfarë është akademiku. Akademiku është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe njëkohësisht mësimdhënës pranë universiteteve publike.

Kur vijmë te çështja e pranimit të anëtarëve të Akademisë, *eks officio*, si anëtarë senati, jam dakord për votën këshillimore. Së pari, jemi në të njëjtën linjë që thotë zoti Ismet, që ndërtojmë ura komunikimi dhe, së dyti, edhe anëtarët e Akademisë janë të zgjedhur dhe ne kërkojmë pikërisht për shkak të *eks officio*-s, pra të pozicionit që kanë, të cilët vijnë të zgjedhur nga universitetet publike për t’u rikthyer aty dhe për të ndërtuar ato pikat për të cilat folëm. Ku do ta marrim ne informacionin?

Një nga gjërat që nuk funksionon në Akademi, unë kam aty 6 vjet, është pikërisht fakti se ne jemi të izoluar, sepse ligji nuk na jep mundësinë që të komunikojmë për t’u afruar me njëri-tjetrin. Përsëri tani, megjithëse po ndërtojmë disa organizma për t’u afruar me njëri-tjetrin, të cilat nuk ndikojnë fare, se nuk e prishim procedurën e zgjedhjes së senatit, sipas ligjit të arsimit të lartë, por në ligjin tonë i njohim një të drejtë akademikut, i cili është mësimdhënës, ta ketë edhe këtë të drejtë, të marrë pjesë në mbledhjet e senatit, për shkakun që është akademik, jo për shkakun se është zgjedhur nga ILA-ja përkatëse.

Unë mendoj se nuk e prishim autonominë, përkundrazi, i shtojmë një burim informacioni shumë të konsiderueshëm akademikut për çfarë ndodh në jetën e institucioneve publike, që merren me këtë kërkimin shkencor.

Milva Ekonomi – Ky është qëllim i mirë, por, në fakt, ajo që kërkojmë ne këtu është që s’duam të bëjmë *overlap* me ligjet dhe duhet t’i respektojmë ato. Në këtë rast, kjo është një gjë e zgjidhshme që është përtej ligjeve, se bashkëpunimi zgjidhet përtej ligjeve.

Erzen Tola – Ndjesë për ndërhyrjen! Lidhur më këtë që përmendi zoti Tole, me përkufizimin e akademikëve brenda kategorisë “profesor” është bërë në mënyrë të qëllimshme nga ligji i arsimit të lartë, për t’ia njohur këtë të drejtë për mësimdhënie dhe kërkim shkencor brenda institucionit të arsimit të lartë, gjë e cila do të thotë që anëtarë të asamblesë, që janë personeli akademik në institucionin e arsimit të lartë, mund të kandidojnë në këto komisione dhe në këto senate, dhe mund të jenë anëtarë, por nuk mund të jenë *eks officio* apo me votë të këshillueshme.

Ne kërkojmë heqjen e kësaj pike.

Vasil Tole – Siç thotë populli: “t’ia heqim petët lakrorit”, se ne kemi qenë pjesë aktive e hartimit të ligjit të arsimit të lartë dhe, për hir të së vërtetës, propozimin për të shtuar titullin “Akademik”, që është pjesë e institucioneve të arsimit të lartë, e kemi bërë ne të Akademisë së Shkencave, se në variantin bazë nuk ishte. Me zotin Mazniku, që ishte zëvendësministër në atë kohë, tentuam ta bënim këtë gjë të ligji i arsimit të lartë. Ne kemi edhe praktikën përkatëse, ku kemi thënë që hajde të parashikohet te ky ligj dhe për çështjen e ngritjes së urës së komunikimit me këto terma që po flasim sot, nuk gjetëm mirëkuptim, kështu që kjo është çështje qëndrimi.

Milva Ekonomi – Meqenëse është çështje qëndrimi, na qëllon që ta votojmë ne këtu, se qëndrim është. Dëshira është e mirë, por ndërkohë është përplasje ligjesh, të cilave ne duhet të përpiqemi t’u japim rrugë. Në këtë rast, ligjin e arsimit të lartë e kemi pasur parasysh, se tani sapo fillon e po formohet struktura e re e veprimit.

Kolegë, si mendoni? Propozimi është për t’u hequr. Relatori ka sjellë një gjykim për ta shtuar.

Kush është dakord që të heqim pikën 8? I kishim gjithë rektorët kundër kësaj pike. Edhe Këshilli i Ministrave ka propozuar për heqjen e kësaj pike.

Shaban Sinani – Ne nuk po insistojmë që të mbahet neni siç është formuluar në projekt, por neni i amenduar, duke hequr edhe *eks officio* dhe duke lënë votë këshillimore.

Milva Ekonomi – Çfarë është vota këshillimore, se nuk e gjejmë dot këtu?

Shaban Sinani – Është votë opinionale.

Milva Ekonomi – Po njësoj është, se ai shkon e dëgjon mbledhjet!

(Diskutime pa mikrofon.)

Erzen Tola – Duke qenë se në Kushtetutë përcaktohet që institucionet e arsimit të lartë janë institucione autonome, përcaktimi i kësaj pike mund ta bënte këtë projektligj antikushtetues. Unë nënvizoj se ne nuk jemi institucioni përgjegjës për këtë projektligj, se nuk është propozuar nga ana jonë, por përpiqemi maksimalisht për të përmirësuar atë masë që e konsiderojmë se është e nevojshme.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Urdhëroni!

Bujar Çela – Duke iu kthyer diskutimeve të rektorëve, unë nuk shoh se ata ishin këmbëngulës për të hequr prezencën e Akademisë së Shkencave, por ata kërkonin veç që akademikët të mos kishin votë, sepse këto dy institucione, që bëjnë shkencë të pavarur, nuk e rëndojnë njëri-tjetrin, por japin e marrin. Nga vjen akademia e shkencëtarëve të rinj? A vjen që andej? Pra, nëse ju nuk do të keni një prezencë në këtë senat, ku do t'i merrni këta.

Kështu që unë mendoj që të rishikohet kjo çështje. Kjo të ruhet si pikë por të hiqet çështja e votës, sepse edhe rektorët ishin të këtij mendimi. Ata thanë të njëjtën gjë, pra ata të jenë siç duan të jenë, se duket sikur po i hapim derën njëres palë dhe po ia mbylлим palës tjetër, kështu që asnjëra palë të mos ketë të drejtë vote. Prezenca unë mendoj që është shkëmbim mendimesh për të vendosur diçka më të mirë.

Milva Ekonomi – Po pse duhet ta vësh te ky ligj?

(Diskutime pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Kjo ka qenë pikë debati nga rektorët. Ne duhet të jemi në koherencë me ligjin e arsimit të lartë dhe me këtë ligj që të mos kemi nonsens.

Së dyti, duhet të jemi korrektë me të gjithë institucionet e zgjedhura që bëhen me konkurrim dhe me votë pavarësisht nga gradat apo statutet që kanë.

Ne kemi përvoja ligjesh dhe statutesh. Te statutet futet *eks officio* direkt, kush ka qenë kryeministër, kush ka qenë kryetar partie, kush ka qenë kryetar Kuvendi e të tjera, kurse këtu jemi në ligj. Akademiku, po të ketë fuqinë konkurruese në trupën universitare, le të konkurrojë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Në përgjithësi, nga rektorati na ka ardhur kjo pjesë që nuk i duan këto pikat. Për shembull, Universiteti i Elbasanit ka sjellë këtë arsyetim: “Kërkimi dhe marrja e informacionit për punën kërkimore-shkencore nuk është qëllimi i këtij ligji dhe për këtë arsye Akademia nuk mund të kërkojë të bashkëpunojë dhe të koordinojë me institucionet e arsimit të lartë në lidhje me punën shkencore apo strategjitë e tyre në lidhje me kërkimin shkencor”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë mendoj se mund të zgjidhet me marrëveshje. Këshilli i Ministrave e hedh poshtë. Unë e kuptoj që është dëshira.

Vasil Tole – Kërkesa për të marrë pjesë në mbledhjet e senatit është thjesht dëshirë që ne të njohim më mirë njëri-tjetrin. Le të jetë kjo urë.

Milva Ekonomi – Po senati i ka të hapura mbledhjet. Ata shpallen në *web*.

(Diskutime pa mikrofon.)

Na lini ta shikojmë këtë gjë! Pikën 8 e lëmë për pak më vonë.

Pika 9.

Ismet Beqiraj – Te pika 9 të ndryshohet vetëm fjala e parë që është opsionale. Të mos thuhet “të marrin pjesë”, por të bëhet “mund të marrin pjesë”. Ky është një korrigjim juridik.

Vasil Tole - Këtu bëhet fjalë që të drejtat dhe detyrat e anëtarëve në këtë rast janë për kryesinë, që kur të vijnë propozime të ndryshme nga institucione publike, ku kërkohet përfaqësimi i Akademisë, përfaqësia e Akademisë të caktojë përfaqësues të vet edhe anëtarë të Akademisë, si një e drejtë që i lind për të qenë anëtar i Akademisë, pra të mos i mbajnë vetëm për vete funksionet, që të shkojë kryetari, zëvendëskryetari, sekretari ose kryetarët e seksioneve, por të caktojnë edhe akademikë, kur kërkohet prezenca e Akademisë diku në një grup pune. Pra, jo thjesht për të zgjedhurit aty, por edhe për ata që mbajnë titullin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Siç është në projektligj, është detyruese, pra marrin pjesë në njësitë apo grupet e punës për shqyrtimin, hartimin dhe kërkimin në fusha të caktuara, ndërsa këtu është lënë që mund të marrin pjesë si një mundësi, jo si një detyrim. Kjo është diferenca.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare, unë reflektoj në propozim dhe jam plotësisht dakord ashtu siç është, pra të mos ndryshohet, se ka të bëjë me detyrat.

Milva Ekonomi – Pra, “të marrë pjesë”, jo “mund të marrë pjesë”...

(Diskutime pa mikrofon.)

Te neni 9, pika 9, të heqim “mund”. Të mbetet siç është në projektligjin bazë.

Vazhdojmë me pikat e tjera.

Neni 9, pika 10. Dakord.

Miratohet.

Neni 9, pika 11 të mbetet siç është.

Miratohet.

Pika 12. A do të fusni konceptin e anëtarëve korrespondentë, se nuk e keni këtu? Dakord.

Neni 10. Do t'i shtojmë këtu korrespondentët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord me këtë ndryshim.

Miratohet.

Neni 11.

Ismet Beqiraj – Te neni 11, te “Kryesia”, jam plotësisht dakord me sugjerimin e KM-së. Këtu nuk parashikohet mënyra se si zgjidhet kryetari dhe relatojmë që të jetë një pikë mënjane, për mënyrën se si zgjidhet kryetari dhe të merret *mot-a-mot* ajo që është te statusi aktual i Akademisë së Shkencave.

Milva Ekonomi – Ne duam specifikisht mënyrën e zgjedhjes së kryetarit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Erzen Tola - Neni 8, pika 6 përcakton procedurat e zgjedhjes së funksionarëve së Akademisë së Shkencave, kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit shkencor. Formulimi në statut është që bëhet me votim të fshehtë dhe me shumicë absolute të anëtarëve.

Ismet Beqiraj - Te neni 11 propozojmë një shtesë, para pikës 5 të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, anëtari i kryesisë emërohet në detyrën e mëparshme dhe në pamundësi në një detyrë të përafërt me të”.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me këto ndryshime, të cilat do të formulohet dhe do të vendosen këtu?

Dakord. A ka kundër?

Miratohet.

Neni 12 “Detyrat edhe kompetencat e Kryesisë”.

Ismet Beqiraj – Në këtë nen nuk ka ndonjë propozim. Të lihet siç është.

Milva Ekonomi – Dakord.

Vasil Tole – Propozimi akademik i zonjës Anastasi, me të cilin u njoha tani, në fakt, mua më duket shumë i drejtë, por prapë hap debat. Le të marrim rastin kur akademikja Anastasi ka të drejtë të konkurrojë nesër për kryetar të Akademisë, zëvendëskryetar, sekretar apo kryetar seksioni. Pra, ajo vjen nga bota universitare, se prapë kemi të bëjmë me marrëdhënien mes dy realiteteve. A ia ruan dot ky ligj vendin në universitet? Ky është thelbi.

Unë jam plotësisht dakord që një profesor të vijë të drejtojë një seksion ose edhe Akademinë e Shkencave, me të drejtën që kur mbaron mandatin, të mos ngelet në rrugë. Duhet një lloj fleksibiliteti në çështjen e trajtimit të këtyre marrëdhënieve.

Milva Ekonomi – Nuk e zgjidh as ky ligj këtë gjë, sepse universitetet kanë një ligj tjetër. Problemi është se do sigurinë e përrjetshme, por në këtë botën tonë nuk ka siguri të përrjetshme! Nuk mund të jetosh me sigurinë absolute!

Vasil Tole – Atëherë, të mos i kërkohet Akademisë së Shkencave pse ka një kandidat për kryetar, një për zëvendëskryetar, sepse anëtarët druhen pikërisht nga këto situata.

Kur u kemi thënë edhe atyre të platformave alternative që të kandidojnë, nuk vjen askush. Profesorët e universiteteve janë të parët që kanë frikë të lënë vendin e punës.

Milva Ekonomi – Unë mendoj që ky ligj është shumë më i mirë, më i qetë, më i lirë, se kemi punuar shumë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Meqenëse ne jemi në diskutimin e propozimit për të pasur sigurinë e kthimit të vendit të punës, a jeni dakord me propozimin e Anastasit? Unë nuk jam dakord.

Kush është kundër?

Miratohet siç është.

Kalojmë te “Detyrat dhe kompetencat e Kryesisë”.

Mbetet siç është.

Kalojmë te “Kryetari”.

Ismet Beqiraj – Këtu të vendoset “zgjedhje dhe detyra”.

Milva Ekonomi – Po sikur e bëmë zgjedhjen atje sipër! Apo ta vendosim këtu?

Këtë e lëmë siç është, ndërsa te zgjedhja e kryesisë, vendosim edhe zgjedhjen e kryetarit.

Ismet Beqiraj – Ka një propozim nga KM-ja, ku sugjerohet që kryetari nxjerr vetëm urdhëra të brendshëm në bazë të Kushtetutës. Të drejtën për të nxjerrë udhëzime e ka vetëm KM-ja.

Te pika 2 dhe te drafti që keni përpara është pasqyruar.

Po në këtë pikë unë, si relator, kam bërë një propozim që nga 45 ditë të bëhet 20 ditë dalja e dekretit të Presidentit për kryetarin e Akademisë, duke ndjekur praktikën që 7 ditë kanë dekretet dhe 20 kanë ligjet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Dakord, e lëmë 15 ditë.

Kjo mund të shkojë edhe te pjesa e zgjedhjes së kryetarit, që pas votimit, brenda 15 ditëve Presidenti ka të drejtë ta dekretojë.

Jeni dakord me këtë riformulim?

Kush është dakord me nenin 13?

Miratohet.

A mund të bëj një pyetje?

Kryesia ka kryetar, zëvendëskryetar, sekretarin shkencor dhe kryetarin e seksioneve. A t'i japim nga një detyrë në ligj këtyre?

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë them që duhet t'u jepni një diçka të përgjithshme funksioneve të kryesisë, se nuk shkoni dot në statut. Për shembull, zëvendëskryetari zëvendëson kryetarin, që sekretari ka një detyrë, pra një përkufizim të përgjithshëm dhe ato zgjerohen në statut. Ne mund të marrim 2-3 gjëra të rëndësishme nga statuti dhe t'i vendosim këtu.

Unë mendoj që pas kryetarit të vendosim me radhë, sipas sugjerimit të Vasos, zëvendëskryetarin, sekretarin, kryetarin e seksioneve, nga një përshkrim të vogël, dhe kështu shtohet numri i neneve mbi bazën e këtyre figurave, pastaj shkojmë te vlefshmëria.

A jeni dakord që të bëjmë këtë përshkrim të vogël të detyrave të kryesisë?

Kush është dakord? Kundër?

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasil Tole – Te neni 12, pika 3 mund të shtohet kjo.

(Diskutime pa mikrofon.)

Erzen Tola – Duhet të bëjmë një ndryshim, jo “sekretari shkencor”, por “kancelari”, sepse në këtë ligj ripërkufizohet figura...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Neni 14.

Ismet Beqiraj – Ju lutem që të regjistrohet, te neni 12, të shtohet pika 3 me këtë përmbajtje: “Detyrat dhe kompetencat e zëvendëskryetarit, sekretarit shkencor dhe kryetarit të seksioneve përcaktohen në statut”.

Milva Ekonomi – Ne e kemi votuar nenin 12, por nuk e kishim marrë parasysh këtë ndryshim. Tani rikthehem dhe duhet ta hapim përsëri votimin për këtë nen. Kijeni parasysh!

Vasil Tole – Ju lutem, që të jemi korrektë me termat, edhe te neni 11, pika 2, duhet jo “sekretari”, por “sekretari shkencor”.

Milva Ekonomi – Dakord.

Duhet të vendosim pikën 4, për mënyrën se si zgjidhet kryetari.

Vasil Tole – Me votim të fshehtë dhe me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve. Ky është formulimi.

Meqë e nxorëm më vete kryetarin, ai zgjidhet njëloj si kryesia, por duhet ta evidentojmë.

Milva Ekonomi – Sa kohë e ka mandatin kryetari?

Vasil Tole – 4-vjeçar.

Milva Ekonomi – Kolegë, të gjitha këto ndryshime që kanë ndodhur sot do të zbardhen në variantin final dhe nesër, kur të vijmë në mbledhje, do të kemi një kopjo të zbardhur të variantit integral.

Ne do të marrim në konsideratë vetëm këto ndryshime që bëmë sot të zbardhuara në letër.

Pra, vendosëm që gjysma e dytë e pikës 2, të nenit 13, kalon te gjysma dytë e pikës 4, të nenit 11. Mos harroni që është Presidenti që e miraton atë që ju zgjidhni!

Te neni 13 kemi gjysmën e dytë, ku vendosëm 15 ditë për dhënien e dakordësisë së Presidentit. Këtë e çuam te neni 11, pika 4, të cilën mund ta bëjmë pika 5.

Tani jemi te neni 14, “Vlefshmëria”.

Ismet Beqiraj – Te pika 2 duhet zëvendësuar “shkencor” me “akademik”. Pra, janë tituj akademikë, jo tituj shkencorë.

Milva Ekonomi - Dakord jeni ju të ministrisë?

Pro? Kundër?

Miratohet neni 14.

Neni 15.

Ismet Beqiraj – Lidhur me nenin 15 unë, si relator, propozoj që te pika e parë mosha 65 vjeç të bëhet 68 vjeç dhe 60 vjeç të bëhet 65 vjeç, në përputhje edhe me kohën e daljes në pension të profesorëve dhe pjesës tjetër.

Te pika 1 duhet të bëhet që: “nuk duhet të zgjidhen anëtarë të asamblesë persona mbi 68 vjeç dhe 65 vjeç si akademikë të asociuar”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasil Tola – Zonja Milva, jemi shumë dakord me këtë rritje të pragut të moshës, vetëm a mund ta formulojmë ndryshe, jo kështu në mënyrë pexhorative “nuk mund të zgjidhet”? A mund ta themi që anëtarë të asamblesë zgjidhen personat nën këtë moshë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Atëherë, a jemi dakord me këtë riformulim dhe me këtë rritje të moshës?

Pro? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Neni 16 “Ndërprerja e mandateve”.

Ismet Beqiraj – Duhet të kalojë, se me “shumicë absolute” u bë e qartë situata e votave.

Milva Ekonomi - Dakord.

Miratohet neni 16. Dakord.

Neni 17 “Seksionet”.

Ismet Beqiraj – E lëmë sikurse është propozuar.

Milva Ekonomi - Jeni dakord?

Neni 18 “Komisionet”.

Ismet Beqiraj - Edhe komisionet kalojnë ashtu siç është propozuar.

Milva Ekonomi – Neni 19 “Njësitë e kërkim-studimit”.

Ismet Beqiraj - Te neni 19, që ka të bëjë me njësitë e kërkim-studimit, ka një propozim për pikën 3: “Sipas rëndësisë, problemeve, kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të asamblesë për njësitë me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera”. Pra, për ngritjen e tyre duhet të jetë më mire një vendim kolegjial sesa një strukturë më e ngushtë, siç është kryesia apo vetë kryetari i asamblesë.

Milva Ekonomi – Domethënë ose kanë asamblenë, ose Këshillin e Ministrave?

Ismet Beqiraj - Më fal, se nuk e lexova deri në fund: “Sipas rëndësisë, problemeve, kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të asamblesë për njësitë me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera”.

Vasil Tole - Kisha vetëm një gjë, kjo ka të bëjë me ardhmërinë e Akademisë, që të ketë pranë vetes njësi kërkimore që t’u përgjigjet më mirë gjërave të tjera. Domethënë, sugjerimin e zotit Beqiraj e shoh pjesërisht me vend. Nuk keni pse e përjashtoni kryesinë. Nga 3 veta që janë aktualisht, kryetar, zëvendëskryetar dhe sekretar, jemi bërë 6 veta, duke përfshirë edhe ata. Pra, le të ikë kryetari, jam dakord, por lini kryesinë të ketë të drejtë të shprehet për këto punë.

“Këto njësi ngrihen me akte të asamblesë dhe kryesisë, për njësitë me afat deri në dy vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera”, pra shtojeni edhe kryesinë, se do të na e bëni të pamanovrueshme. Mbledhja e asamblesë është një hall më vete te ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dy herë në vit e kemi lënë tani. Duhet që të godasim, siç po mbledhemi të premten për dekretin e Presidentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të jetë edhe kryesia.

Milva Ekonomi – Jeni dakord kolegë?

Erzen Tola – Ju kërkoj ndjesë!

Në qoftë se mund të rikthem edhe një herë te neni 16, sepse kaloj pak shpejt, ka një përcaktim në germën “b” të pikës 1, që thotë: “Për shkelje të Kodit të Etikës në kërkimin shkencor”, ky lloj Kodi nuk ekziston dhe mendoj të shikohet në projektligj, sepse përderisa nuk ekziston...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk është propozuar.

Vasil Tole - Mund të jap një shpjegim? Ju e dini që Akademia është anëtare e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Europës dhe ne, me vendim të brendshëm të asamblesë kemi aprovuar dhe e njohim si tonin Kodin e Etikës së Kërkimit Shkencor. Pra, është një vendim që ne e zbatojmë.

Fakti që vendoset këtu për komprometimin e rëndë të figurës së akademikut, është një gjë që ka të bëjë me një akt ndërkombëtar për figurën e akademikut, të cilin tashmë e kemi aprovuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbi këtë e nisim edhe punën e projektligjit tjetër, por unë them se nuk ka kontradiktë. Kodi i Etikës është një dokument ndërkombëtar për integritet në kërkimin shkencor dhe është i pandryshuar prej 30 vitesh.

Shaban Sinani - Të gjitha akademitë anëtare të ALEA-s, në mënyrë vullnetare janë të detyruara të zbatojnë Kodin e Antologjisë së Kërkimit Shkencor. Ai është një dokument european tipik reference për atë që përbën penalitet...

(Mungesë audio.)

Milva Ekonomi – Më falni, se nuk e kisha hapur mikrofonin!

E mori Gazi, e vendosi këtu, e propozoi Erzeni për të bërë kujdes, bënë diskutim Akademia, ndërkohë iu referuam parimeve të Akademisë së Shkencave të Arteve të Europës dhe thamë që ato punojnë mbi parimet e deontologjisë dhe kjo do të kalojë e përshkruar. Gazi është i qartë tani.

Lidhur me neni 19 ramë dakord me ndryshimin që u propozua nga Ismeti dhe u përmirësua nga Vaso. Ne e votuam dhe jemi dakord me të.

Kalojmë te neni 20 “Akademia e të Rinjve”.

Ismet Beqiraj - “Akademia e të Rinjve” është një risi e rëndësishme e këtij projektligji.

Meqenëse relatorja e grupit nismëtar ka bërë propozime, sidomos për moshën, edhe unë si relator bie dakord te pika 1, nga 42 vjeç, mosha propozohet të jetë 45 vjeç. Kjo gjë që sugjerim edhe i rektorëve të universiteteve gjatë dëgjësave.

Milva Ekonomi – Kemi ndonjë propozim tjetër për moshën?

Bujar Çela – Flasim për Akademi të re, flasim për hapje, pse të mos e afrojmë moshën 40 vjeç, t’u japim mundësi atyre që e kalojnë klasën?

Unë propozoj të bëhet mosha 40 vjeç, pasi jam konsultuar edhe me juristin e komisionit.

Vasil Tole - Në fakt, edhe ne të Akademisë jemi për uljen e pragut, sepse në rast se e lëmë moshën 45, nuk do të kemi mundësi të pranojmë të rinj, sepse 20 veta janë anëtarët, të cilët i trajtojmë si akademikë, duke iu mbështetur botimet, udhëtimet e të tjera, kështu që është mirë të jetë 40 vjeç, që të vijmë të rinjtë dhe t’i gëzojnë frytet.

Milva Ekonomi – Me propozimin që bëri Bujari dhe me mbështetjen e zotit Vaso, jeni dakord ta ulim moshën ta çojmë 40 vjeç?

Miratohet me ndryshimin “mosha 40 vjeç”.

Ismet Beqiraj -Te pika 4, në fund fare “Akademia e të Rinjve funksionon si organizëm autonomy, në bazë të një statuti të miratuar prej saj dhe prej kryetarit të asamblesë”, sugjerojmë që ta miratojë asambleja, njëlloj sikurse miraton dhe statutin dhe rregulloret e saj.

Vasil Tole - Na është dashur shumë punë për të mbushur edhe mendjet e akademikëve për nevojën e krijimit të Akademisë së të Rinjve, se duken si normalitete këto gjëra, për të cilat ne punuam 4 vjet që të ndryshonte mentaliteti pse duhen të rinjtë, pse duhet të krijohet Akademia e Shkencave e të tjera. Ne e bëmë këtë gjë. Ju lutem, na jepni operativitet!

Duhet të jetë një firmë e miratuar nga kryetari i Akademisë, sepse na lehtëson punën, se po shkuam në asamble, aty janë 40 veta. Le t’ia japim autonominë shkencëtarëve të rinj ta bëjnë këtë. Ne do të ftojmë ekspertë të huaj për ta parë këtë punë, sepse këtë model e kemi marrë nga Europa. Ndaj, lejoni kryetarin e Akademisë ta certifikojë statutin dhe në rast se ka ndonjë gjë për të plotësuar, e diskutojmë ngushtë më pas.

Milva Ekonomi – Erzen, po ti si mendon?

Erzen Tola – Nga pikëpamja funksionale mendoj se miratimi nga kryetari do të ishte shumë i shpejtë dhe efikas, por edhe nga asambleja do të jetë shumë e vështirë, duke qenë se

mbledhet dy herë në vit. Asambleja mund të bëjë mbledhje të jashtëzakonshme edhe për miratimin e statutit, por mendoj se do të ishte më mirë që statuti të miratohej me vendim të kryesisë sesa të kryetarit dhe jo të asamblesë.

Milva Ekonomi – Pra, do ta lemë “Me një statut të miratuar me vendim të kryesisë”. Jeni dakord ta miratojmë nenin 20 me këto dy ndryshime, “ulet mosha” dhe “me vendim të kryesisë”?

Miratohet!

Kalojmë te neni 21 “Marrëdhëniet me institucionet shtetërore”.

Ismet Beqiraj - Te neni 21, te pika e parë “Akademia ia përcjell raportin vjetor të veprimtarisë së saj Këshillit të Ministrave dhe ministrisë përgjegjëse për Shkencën, dhe komisionit parlamentar përkatës”, vetëm kjo fjalë është shtuar. Pra, kemi të bëjmë vetëm me një rregullim.

(Diskutim pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Deri në fund të tremujorit të parë pasardhës...

Gazi, mbaji shënim, të lutem!

Ismet Beqiraj - Shtohet një pikë pas pikës 3, bëhet pika 4: “Një herë në vit organizohet dialogu Akademi – Këshilli i Ministrave, sipas një marrëveshjeje dypalëshe”. Pra, “qeveri” në këtë rast quhet “Këshilli i Ministrave”.

Erzen Tola – Nga pikëpamja e teknikës legjislative është saktësuar që të mos përdoret termi “qeveri” por “Këshilli i Ministrave”.

Vasil Tole - Një herë në vit organizohet dialogu politikë-shkencë, mund të vendoset pastaj Akademi – qeveri sipas një marrëveshjeje dypalëshe. Kështu krijohen vërtet urat e nevojshme të komunikimit me njëri-tjetrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – “Administrata”, neni 22.

Ismet Beqiraj - Te neni 22 është reflektuar sugjerimi i Këshillit të Ministrave për pasaktësi të numërimeve në përputhje me teknikën legjislative, te pika 1, dhe janë kaluar nga 1 deri në 5 germa: “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.

Nga ana tjetër, po te kjo pikë, fjala “administrator” bëhet “detyrat e tjera të kancelarit përcaktohen në statut në rregulloren e institucionit”. Pra, nuk është më “administrator” por “kancelar”.

(Diskutim pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Kush e zgjedh kancelarin?

(Diskutim pa mikrofon.)

Duhet ta vendosim në ligj këtë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Në pikën 2, të nenit 22? Nuk e shoh!

Ismet Beqiraj - “Zgjedhja e kancelarit, mënyra e pranimeve në administratë, si dhe mënyra e funksionimit të saj, përcaktohen në rregulloren e brendshme të miratuar nga kryesia, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi”.

Atëherë, në vend të fjalës “nëpunës” lamë fjalën “kancelar”. Mbas fjalës “kancelar” te paragrafi i parë, bëhet pika 2 “Zgjedhja e kancelarit” dhe pastaj bie pika 3 “Detyrat e kancelarit”. Duhet të rregullohet renditja e pikave.

(Diskutim pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Domethënë kjo do të qëndrojë, por do të ketë një renditje tjetër.

Pika 1 “Kryesia e Akademisë në ushtrimin e veprimtarisë së saj...”.

“Nëpunësi më i lartë i saj është kancelari”.

Pika 2 “Zgjedhja e kancelarit, mënyra e pranimeve në administratë, si dhe mënyra e funksionimit të saj, përcaktohet në rregulloren e brendshme të miratuar nga kryesia, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi”. Çfarë ndryshime ka rregullorja e brendshme në krahasim me statutin?

(Diskutim pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj -Rregullorja del në zbatim të statutit.

Milva Ekonomi – E kuptoni, pra, që mungon një hap këtu? Duhet ta riformulojmë. Kush do të na ndihmojë nga djemtë juristë?

(Diskutim pa mikrofon.)

Po, pra, duhet të riformulojmë definicionin e renditjes, jo logjikën, se ajo është në rregull.

Në pikën 3 të këtij neni thuhet: “Struktura, organika dhe niveli i pagave përcaktohen nga asambleja me përfaqësim të kryesisë.”. Domethënë, po të jetë sipas ligjit, si do ta riformulojmë këtë?

Na ndihmo për këtë Erzen, se këtu duhet të ndërmerret edhe një iniciativë tjetër!

Erzen Tola - Lidhur me pikën 3 të këtij projektligji është shprehur Ministria e Financave, e cila konsideron se, në qoftë se do të mbetet sipas këtij formulimi projektligji, duhet të ndryshojë ligji për pagat. Në rast të kundërt, duhet të rishikohet dhe të riformulohet në zbatim të ligjit për pagat, sepse bie në kundërshtim me këtë ligj. Ky është edhe qëndrimi i Këshillit të Ministrave.

Vasil Tole - Në ligjin e cituar “Akademia e Shkencave nuk është një institucion i përmendur nominalisht, bën pjesë tek institucionet e tjera të ngritura me ligj, pagat e të cilëve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, përveç rasteve kur ligji shprehet ndryshe”.

(Diskutim pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Këshilli i Ministrave ka kthyer përgjigje dhe kjo do të thotë që duhet të merret nismë për këtë gjë.

Gazmend Bici - Këshilli i Ministrave është shprehur se nëse Akademia e Shkencave do të jetë institucion i pavarur, sipas ligjit për institucionet e pavarura, do të duhet të listohet te ligji për pagat, duke filluar që nga Presidenti i Republikës e deri tek të gjitha institucionet e tjera, sikurse edhe institucionet e pavarura, si: AMA, AKEP-i apo ente të ndryshme, pra, do të listohet edhe Akademia në mënyrë që punonjësit e saj të trajtohen sipas ligjit për pagat. Këtë ka thënë Këshilli i Ministrave dhe kërkojnë një iniciativë tjetër ligjore për ta ndryshuar këtë ligj.

Vasil Tole - Kjo është rruga e gjatë, por vetë ligji nr. 9854 thotë shprehimisht: “Institucioneve të tjera të ngritura me ligj”, pra ne nuk jemi tek institucionet e pavarura, ne quhemi institucione autonome, por shikoni sa bukur e formulon: “Institucioneve të tjera të ngritura me ligj paga t’u përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, përveçse kur ligji thotë ndryshe”, pra biem dakord që paga të përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Ne e kemi dhënë përcaktimin tonë në kushtet e këtij ligji. Ju lutem, lexojeni!

(Diskutim pa mikrofon.)

Dakord, por na lini hapësirën, që në rast se dëshironi, ta lemë formulimin siç është në ligj, mund të ngelet edhe kështu.

(Diskutim pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Referuar faktit se Institucionet e Pavarura Kushtetuese janë të përcaktuara në mënyrë nominative në ligjin nr. 9584, të vitit 2006, nevojitet të ndërmerret paralelisht edhe iniciativa për rishikimin e këtij neni, për të mundësuar zbatimin e këtij projektligji.

Sugjerojmë që neni 23 i këtij projektligji të riformulohet, duke përcaktuar që Akademia do të financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

Ndërkohë, nëse Akademia parashikon të gjenerojë të ardhura, vlerësojmë se trajtimi i të ardhurave duhet të përcaktohet në një nen më vete, ku të përcaktohen llojet e të ardhurave dhe parashikimi i përdorimit të tyre.

Këto duhet të jenë të mirargumentuara në relacionin shoqërues të projektligjit.

Milva Ekonomi – Duhet të na sillni një tabelë të ndarë në seksione, e keni pasur me 3, të bëhet me 2. Keni pasur 10 veta në 3 seksione, duhet të bëheni 10 veta në 2 seksione. Mund të mos lëvizi paga, por e gjitha kjo është një organizim i ri. Organigrama dhe struktura duhet të dërgohet në komision.

Vasil Tole - Këtë po ua sjellim me *e-mail* te sekretaria.

Ismet Beqiraj – Unë si relator propozoj të bëhet një nen tranzitor, për të përcaktuar statusin financiar të Akademisë së Shkencave.

Milva Ekonomi – Financimi do të bëhet sipas propozimit të Këshillit të Ministrave, ndërkohë duhet të shikoni pikën 3, të nenit 22, sepse formulimi është shumë i gjatë. Qëndrojnë të gjitha?

Ndërkohë, nga shërbimet juridike të Kuvendit u sugjerua që e gjitha të saktësohet në një dispozitë tranzitore. Duhet të ketë një nen shtesë, që është dispozita tranzitore. A u formula kjo?

Gazmend Bici - Jo, sepse është lënë të merret një iniciativë ligjore për këtë.

Milva Ekonomi – Iniciativa ligjore është gjë tjetër, por a u formula dispozita tranzitore?

Duhet të hartojmë një dispozitë tranzitore për pjesën financiare. Do t'ju lutesha anëtarëve të komisionit t'i jepnin kohë grupit të punës të flasin me Shërbimin Juridik për ta bërë këtë gjë, se nuk jemi gati.

Nenet 22 dhe 23 t'i miratojmë nesër, pasi të riformulohen nga Shërbimi Juridik. Ndryshimet i kemi të përfshira në këto nene, ndërsa sugjerimet që do të na vijnë nga Shërbimi Juridik i Kuvendit, do t'i diskutojmë nesër.

Kalojmë te neni 24 “Statuti i Akademisë”.

Zonjat Gjermani dhe Anastasi kanë bërë dy propozime rreth këtij neni.

Ismet Beqiraj – Zonja Anastasi propozon që në këtë nen të përcaktohet afati, brenda të cilit të hartohet dhe miratohet statuti i Akademisë së Shkencave. Pika 2 e këtij neni thotë: “Të miratohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

Nga ana tjetër, po në nenin 24, pika 2, propozon të shtohet një paragraf i dytë, i cili të rregullojë shprehimisht se çfarë do të ndodhë me organet ekzistuese të zgjedhura të Akademisë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Milva Ekonomi – Këtë gjë do ta shikojmë te dispozitat tranzitore, se mund të shtojë diçka edhe Shërbimi Juridik.

Vasil Tole – Unë mendoj se nuk ka nevojë të diskutohet legjitimiteti i zgjedhjeve që kemi kryer. Ne e kemi kryer me ligjin që është në fuqi.

Mandatet janë: kryetari 4, zëvendëskryetari 4, kryetari i seksionit 4 dhe vazhdon mandati siç është normalisht. Nuk ka pasur kontestime.

Ismet Beqiraj – Unë them ta votojmë nenin 24.

Milva Ekonomi – Dakord!

Ismet Beqiraj – Mendoj që edhe nenin 25 ta kalojmë.

Milva Ekonomi – Dakord!

Ismet Beqiraj – Lidhur me nenin 26 unë, si relator, kam bërë një propozim, sepse te drafti fillestar thuhet se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9182 i vitit 2004, të shfuqizohet. Jo, këtë ligj e ka shfuqizuar ligji i vitit 2006, që është në fuqi. Ligji nr. 9655 datë 11.12.2006, i ndryshuar “Për Akademinë e Shkencave”, të shfuqizohet.

Milva Ekonomi – Jeni dakord edhe ju me sugjerimin e relatorit?

Ismet Beqiraj – Ligji i vitit 2004 është shfuqizuar juridikisht.

Vasil Tole – Në fakt, edhe unë e kapa këtë gjë. Duhet vendosur i ndryshuar, se llogarisni që ky ligj që citohet tani, jo i pari, ka pasur 3 ligje të tjera që është amenduar. Kështu që duhet vendosur “i ndryshuar”.

Milva Ekonomi – Dispozitat e fundit që kanë të bëjnë me Akademinë e të Rinjve. Jeni dakord me këtë përmbajtje, se titullin nuk e dimë ende si do ta ketë?

Edhe me nenin 26 “Shfuqizime”, jeni dakord, apo jo?

Miratohet!

(Diskutim pa mikrofon.)

“Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Edhe kjo është standarde.

Sot bëmë punën më të madhe, shtrydhëm trutë dhe duhet t’i themi shumë faleminderit Ismetit që na e lehtësoi punën!

Së dyti, faleminderit juve që ishit prezentë sot dhe na ndihmuat, Erzeni, profesor Sinani dhe Vaso!

Së treti, faleminderit shumë grupit nismëtar dhe zonjës Gjermani!

Së katërti, sot mbaruam diskutimin dhe miratimin nën për nen të këtij projektligji. Ka mbetur votimi dhe miratimi në tërësi. Jam e mendimit ta lexojmë nesër nenin dhe ta miratojmë në tërësi. Jeni dakord? Lëmë një takim nesër për orën 11:00.

Ditë të mbarë!

